

**NJË ANALIZË QË MAT BESUESHMËRINË
DHE PËRGJEGJSHMËRINË FINANCIARE TË
PREMTIMEVE ZGJEDHORE NË 2021**

TETOR
MARS-PRILL
2021

BESUESHMËRIA DHE PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE

**E PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË
POLITIKËS SHQIPTARE NË 2021**



*Me mbështetjen financiare të
Programit të Granteve të Vogla të
Komisionit për Demokraci të
Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë*

BESUESHMËRIA DHE PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË POLITIKËS SHQIPTARE NË 2021

Një analizë që mat besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë financiare të premtimeve zgjedhore në 2021

Përgatitja dhe shpërndarja

Qendra ALTAX

Tetor Mars – Prill 2021

Deklarimi përgjegjësishë

Materiali studimor është realizuar si pjesë e projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Qendrës AL-TAX” si burim informacioni.



Me mbështetjen financiare të
programit të Granteve të Vogla të
Komisionit për Demokraci të
Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë

KUSHTET E PËRDORIMIT DHE ZBATIMIT

Analiza e paraqitur në kontekstin e projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” bazohet në një metodologji që e ka pikënisjen në verifikimin e premtimeve gjatë fushatave zgjedhore dhe programeve gjatë qeverisjeve, që janë rrjedhojë dhe sintezë e premtimeve zgjedhore përballë dokumentave kryesore të shtetit, si: strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, programet zhvillimore dhe ekonomike shumë-vjeçare, programet buxhetore afatmesme, të dhëna studimore dhe raporte nga organizata të huaja dhe vendase dhe dinamikat e ecurisë së ligjeve në funksion të premtimeve. Metodologjia e studimit është zhvilluar në bashkëpunim me ekspertë dhe partnerë kryesorë të ALTAX përmes një procesi konsultativ. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës ALTAX. Të dhënat në këtë raport janë objekt ndryshimi pa paralajmërim. Termat përfshijnë sektorë të ndryshëm të jetës së vendit.

Kur ky raport për të cilin është burimi Qendra ALTAX shpërndahet ose riprodhohet, ai duhet të paraqitet me saktësi dhe t’i atribuohet ALTAX. Kjo kërkesë për cilësinë e burimit duhet ti bashkangjitet çdo përdorimi të të dhënave dhe komenteve, qoftë të marra direkt nga ALTAX ose nga një përdorues tjetër.

Përdoruesit që shkarkojnë Raportin “Besueshmëria dhe Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2021” dhe e vënë në dispozicion të të tjerëve përmes çdo lloji shpërndarjeje ose shkarkimi bien dakord të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të komunikuar dhe promovuar pajtueshmërinë nga përdoruesit e tyre përfundimtarë me këto terma.

Përdoruesit që synojnë të shesin Raportin “Besueshmëria dhe Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2021”, si një produkt i pavarur, ose pjesërisht duhet të marrin fillimisht leje nga Qendra ALTAX.

Dokumenti mund të lexohet te www.altax.al dhe www.polifakt.al

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini tek info@polifakt.al

RRETH STATUSIT TË RAPORTIT

Ky raport analitik është përgatitur për qëllime të projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017”, i zbatuar nga Qendra ALTAX. Teksti i analizës bazohet mbi vlerësime dhe supozime të referuara në informacione zyrtare partiake dhe monitorim direkt në fushatën zgjedhore të tre drejtuesve kryesorë të tre partive politike shqiptare duke pasqyruar një pozicion, i cili synon të përshtatet me frymën dhe qasjen e Qendrës, pa synuar të përshtatë informacione të burimeve referuese. Kjo iniciativë është një proces qytetar i shoqërisë civile, i krijuar për të komunikuar me grupet e interesit për të diskutuar tema kritike për komunitetet e tyre, për të mbledhur informacione vepruese për t’i kuptuar më mirë ato çështje, si dhe për t’u përfshirë në dialog me aktorët politikë qendrorë dhe lokalë në mënyrë që ata të zhvillojnë zgjedhje bazuar mbi premtime korrekte, transparente, të besueshme dhe të matshme në funksion të interesit publik.

Në respektim të përmbajtjes së raportit studimor, nuk ka asnjë pjesë që të dalë në kundërshtim me politikat dhe qëllimin mbi të cilin është organizuar Qendra, apo të flasë në emër të palëve të interesit të përmendura në raport. Të dhënat e përfshira dhe që janë pjesë e studimit nuk përmbajnë huazime apo tekste që përkohjnë me botime të tjera, duke ofruar gjetje autentike. Përmbajtja e dokumentacionit të raportit analitik është e verifikuar me kujdes, e analizuar për gabime të natyrave të ndryshme, apo për ndonjë gabim të çdo lloji. As autorët, por as edhe Qendra nuk mbajnë përgjegjësi nëse teksti kuptohet sikur është duke folur në emër të palëve të tjera, të funksioneve apo detyrave që mbulohen dhe janë fushë përgjegjësie e institucioneve shtetërore duke mbajtur përgjegjësi vetëm për atë çfarë është pjesë e analizës dhe gjetjeve të konkluduara nga vetë autorët. Ky status duhet të vlejë për çdo pjesë të këtij studimi, i cili konceptohet si një dokument integral dhe duhet lexuar si i tillë. Raporti i është nënshtruar një procesi konsultimi me përfaqësues nga shoqëria civile, ekspertë të ekonomisë, financave, shëndetësisë, industrisë, infrastrukturës, arsimit, sindikatave, organizatave të ndryshme dhe ekspertë të shoqërisë civile, pa dashur të jetë shterues në përmendjen e gjithë ekspertëve të fushave të tjera.

Mirënjohje

(SHQIP) Qendra ALTAX falënderon në mënyrë të veçantë grupin e vëzhguesve në rajonet e vendit që kanë ndjekur direkt fushatën zgjedhore të drejtuesve të tre partive kryesore në vend gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore (25 Mars – 24 Prill 2021), si dhe rrjetin e ekspertëve dhe stafit që u vendos në funksion të analizës studimore për punën e bërë në mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre, analizimin dhe seleksionimin, si dhe një falënderim të dedikuar për dizajnerin për formatimin e bërë këtij publikimi.

ALTAX është një iniciativë think-tank shqiptare e asistuar nga ekspertë të sektorëve të ndryshëm dhe analistë të politikës fiskale, duke synuar një qasje të re të politikës dhe kornizës ekonomike shqiptaro-evropiane që ndihmon integrimin. Si një organizatë tërësisht apolitike, puna e gjithë pjesëmarrësve rezultoi të ishte e pandikuar nga asnjë palë dhe kjo ka ndikuar në cilësinë e gjetjeve dhe peshën që përmban analiza sintetike nga skanimit i premtimeve të politikanëve shqiptarë. ALTAX përfaqëson interesat e taksapaguesve, si një qendër e pavarur, në rolin e një komentuesi dhe monitoruesi të financave publike, politikës fiskale, kuadrit ligjor, zbatimit të ligjit, politikave sociale dhe pabarazive sociale në shpërndarjen e mirëqenies duke vlerësuar qasjen e politikave me qëllim promovimin e zhvillimeve në Shqipëri.

Ne falënderojmë kolegët tanë nga KRIIK Albania, të cilët ofruan shërbimin e tyre, duke shërbyer edhe si një burim referimi të informacioneve në ndihmë direkte të raportit për premtimet zgjedhore 2021.

Ne gjithashtu dëshirojmë t'u tregojmë mirënjohje ekspertëve dhe analistëve të ndryshëm për ndarjen me ne të ideve dhe komenteve të tyre gjatë procesit të realizimit të raportit.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që fazat në të cilat kaloi ky raport ishin një sfidë e vështirë jo vetëm për ALTAX, por edhe për vetë kontributorët, të cilët me përvojën dhe organizimin e tyre arritën që të përçojnë në këtë raport pjesët më të përzgjedhura të mozaikut të zgjedhjeve të dekadës së fundit bashkë me problematikat dhe veçantitë e tyre.

Acknowledgements

(ENGLISH)) The ALTAX Center especially thanks the group of observers in the regions of the country who have directly followed the election campaign of the leaders of the three main parties in the country during the official period of the election campaign (March 25 - April 24, 2021), as well as the network of experts and the staff dedicated to this analysis for the work done in collecting data, processing them, as well as a dedicated thanks to the designer for the formatting of this publication.

ALTAX is an Albanian think-tank initiative assisted by experts of various sectors and fiscal policy analysts, aiming at a new approach to Albanian-European political and economic framework assisting integration.

ALTAX represents the interest of taxpayer and is founded to help, increasing the knowledge and education about the implementation in the right way of fiscal policies and public finances management. We are organized and work based on the principle "Right from the start".

As a completely apolitical organization, the work of all participants turned out to be uninfluenced by any party and this has affected the quality of the findings and the importance of the synthetic analysis from scanning the promises of Albanian politicians

We thank our colleagues from KRIIK Albania, who provided their service, also serving as a reference source of information in direct assistance of the report on election promises 2021.

We would also like to show our gratitude to the different experts and analysts for sharing with us their ideas and comments during this analysis.

We are aware that the stages that this report went through were a difficult challenge not only for ALTAX, but also for the direct contributors themselves, who with their experience managed to follow in this report the most selected pieces of the mosaic of the political elections of the last decade together with their problems and peculiarities.

PËRMBLEDHJE

(SHQIP) Në kontekstin e zbatimit nga Qendra ALTAX të projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve shqiptarë, 2009 – 2017”, pas realizimit të raportit analitik sipas temës së projektit ku u përfshi periudha e cila përmbledh tri zgjedhjet politike më të fundit (2009, 2013 dhe 2017), tashmë në këtë kohë para fushate zgjedhore 2021, si moment kulmor për të kontribuar me gjetjet dhe analizën e bërë mbi premtimet nga fushata zgjedhore aktuale ne synojmë të biem me të dhëna në kohë reale gjithë sa u përcoll për opinionin publik për zgjedhjet e kaluara. Raporti aktual “Besueshmëria dhe Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2021” është pjesë e faqës së dytë të projektit të përmendur më lart, i mbështetur nga Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë.

Qëllimi që synohet të arrihet me këtë Raport të dytë mbi monitorimin e besueshmërisë dhe përgjegjshmërinë financiare të premtimeve të tri partive kryesore në vend është konsiderimi i gjetjeve në ballafaqim me të njëjtën bazë referuese si është përcaktuar në Metodologji, për ti treguar votuesve shqiptarë se si vijon përgjegjshmëria e politikanëve shqiptarë pas 4 vitesh, por edhe pas një prezantimi të bërë nga Qendra ALTAX të premtimeve, që nuk duhet të jenë njësoj nga politika me synimin për të kërkuar një qasje të re për të rifituar besueshmërinë nga publiku.

Ky raport analitik i ditë për nga tipi i analizës së kryer për premtimet zgjedhore është orientuar përsëri duke ballafaquar premtimet elektorale, të kategorizuara sipas sektorëve ekonomikë dhe jetësorë të vendit me dokumentet kryesore strategjike sektoriale, programet kombëtare ekonomike dhe fiskale disa vjeçare, programet buxhetore afatmesme, kuadri makroekonomik dhe fiskal, si dhe dokumente të aprovuara në nivel kombëtar lidhur me qasjen integruese të vendit (Programi Kombëtar për Integrimin Europian).

Ky nivel krahasimi me dokumentacionin si më lart konsiderohet, si mundësi dhe përgjegjshmëri informacioni që duhet dhe zotërohet njësoj nga të gjitha palët garuese politike, si dhe është përmbi partitë politike dhe qeverisja e ardhme për vetë rëndësinë e tyre.

Në varësi të analizës është bërë edhe kategorizimi i premtimeve në (a) premtime të matshme dhe të besueshme, (b) premtime të matshme, por pjesërisht të besueshme, (c) premtime të pamatshme.

Nga klasifikimi i premtimeve politike për secilën parti është vijuar me ndërtimin e rasteve ilustruese duke dhënë përgjigje nëpërmjet analizës pyetjeve dhe gjetjeve të tilla, si:

- Çfarë lloj premtimesh u dhanë gjatë fushatës zgjedhore 2021, dhe sa besueshmëri ka ajo në raport me fushatat e kaluara zgjedhore të trajtuara në raportin e mëparshëm?
- Sa e kanë marrë në konsideratë partitë politike përgjegjshmërinë e trajtimit të premtimeve me mundësitë reale të buxhetit të shtetit në rastin kur kemi efektet nga pandemia Covid-19?
- Çfarë referencash/analizash dhe transparence përdorin partitë politike në hartimin e premtimeve të tyre në këto zgjedhje politike?

Në mbyllje të raportit, nëpërmjet ndjekjes së linjës së premtimit nga fillimi i fushatës deri në përmbjlljen e saj do të paraqesim edhe kostot buxhetore e fiskale, por edhe ndryshimin zgjedhjet më të fundit të vitit 2017. Ne do të paraqesim dhe do tu japim vijimësi trajtimi në gjetjet kryesore edhe atyre problematikave të evidentuara në raportin e mëparshëm.

Në fund të raportit jepen në formën e përmbledhjes edhe disa komente kyçe lidhur me gjithë analizën mbi përgjegjshmërinë e kostos buxhetore të premtimeve të vitit 2021, të cilat kanë ndikim direkt në ekonomi dhe te qytetarët.

Gjithë përmbajtja e analizës tenton të hapë dhe mbajë të gjallë diskutimin lidhur me sensibilizimin e njerëzve nëpërmjet analizës ekonomike dhe financiare të premtimeve të besueshme dhe atyre që nuk janë të besueshme duke shprehur nëpërmjet kësaj mënyre komunikimi edhe nevojën për të kuptuar ndryshimin në nivelin e përgjegjshmërisë së nevojshme në kontratën 4-vjeçare që duhet të votohet midis politikanëve dhe votuesve .

ABSTRACT

(ENGLISH) In the context of the implementation by the ALTAX Center of the project "Financial accountability of the promises of Albanian politicians, 2009 - 2017", after the implementation of the first analytical report according to the project topic, which included the period which summarizes the last three political elections (2009, 2013, and 2017), already at this time before the 2021 election campaign, as a culminating moment to contribute to the findings and analysis made on the promises from the current election campaign we aim to fall with real-time data all that was conveyed to the public opinion about the elections.

The main goal of this Second Report is to oversee the financial monitoring of the promises of the three main parties in the country, to consider the findings in comparison with the same reference base as defined in the Methodology, to show Albanian voters how the responsibility of Albanian politicians continues after 4 years from last political elections, but even after a presentation made by the ALTAX Center of promises, which we consider that should not be the same from politics with the aim of seeking a new approach to regaining credibility from the public.

This day-to-day analytical report on the type of analysis conducted for election races is again oriented by confronting the electoral promises, categorized according to the economic and vital sectors of the country with the main sectoral strategic documents, national economic and fiscal programs for several years, budget programs medium-term, macroeconomic and fiscal framework, as well as nationally approved documents related to the country's integration approach (National Program for European Integration).

This level of comparison with the documentation as above is considered as an opportunity and responsibility of information that is needed and possessed equally by all political parties involved and is above political parties and future governance for their own importance.

Depending on the analysis, promises are categorized into (a) measurable and believable promises, (b) measurable but unbelievable promises, (c) non-measurable promises.

From the classification of political promises for each party, the construction of illustrative cases has been continued, giving answers through analysis to questions and findings such as:

- What kind of promises are made during the 2021 election campaign, and how credible are they compared to the previous election campaigns promises addressed in the previous report?
- To what extent have the political parties considered the responsibility of handling the promises with the real possibilities of the state budget in case we have the effects of the Covid-19 pandemic?
- What references / analysis and transparency do political parties use in drafting their promises in these political elections?

At the end of the report, by following the promise line from the beginning of the campaign until its end, we will present the budget and fiscal costs, but also the change of promises with the last elections of 2017. We will present and give continuity of treatment in the main findings even those problems identified in the previous report.

At the end of the report are given in the form of a summary some key comments regarding the whole analysis on the responsibility of the budget cost of the promises of 2021, which have a direct impact on the economy and citizens.

The whole content of the analysis tends to open and keep alive the discussion regarding the sensitization of people through economic and financial analysis of reliable and unreliable promises, expressing through this way of communication the need to understand the change in the level of responsibility of required in the 4-year contract to be voted on between politicians and voters.

Terma dhe përkufizime

AKSHI	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ASHK	Agjensia Shtetërore e Kadastrës
BE	Bashkimi European
BSH	Banka e Shqipërisë
CPI	Indeksi Perceptimit të Korrupsionit
DAR	Drejtori Arsimore Rajonale
DCED	Komiteti i Donatorëve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ERE	Enti Rregullator i Energjië
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
EUROSTAT	Statistikat Europiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
HEC	Hydrocentral
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
INSTAT	Instituti i Statistikave
KMF	Kuadri Makroekonomik e Fiskal
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
LGJK	Ligji i Gjykatës Kushtetuese
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
LTA	Ligji i Tatimit mbi të Ardhurat
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEI	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OSHEE	Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto

PEF	Programi Ekonomik dhe Fiskal
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste
SESH	Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TAP	Trans Adriatik Pipeline
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
UK	Ujësjetës-Kanalizime
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WORLD BANK	Banka Botërore

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Metodologjia	Faqe.....11
PJESA 1	
Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale në 2021	Faqe.....15
1.1. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale	Faqe.....15
1.2. Analiza paralele/ tematike nga të tjera organizata për premtimet 2021	Faqe.....17
1.3. Vendimet e Qeverisë dhe Ligjet e miratuara në prag fushate	Faqe.....18
PJESA 2	
Premtimet e partive kryesore politike	Faqe.....21
2.1. Premtimet e Partisë Demokratike	Faqe.....24
2.2. Premtimet e Partisë Socialiste	Faqe.....25
2.3. Premtimet e Lëvizjes Socialiste për Integrim	Faqe.....27
PJESA 3	
Besueshmëria dhe analiza e premtimeve elektorale	Faqe.....30
3.1. Besueshmëria e premtimeve zgjedhore 2021 dhe 2017	Faqe.....30
3.2. Analiza e premtimeve dhe qasja e partive ndaj tyre	Faqe.....32
3.3. Referimi të vizioni vendit dhe përgjegjshmëria në përçimin e tij	Faqe.....35
3.4. Kostoja buxhetore dhe fiskale e premtimeve të partive	Faqe.....40
PJESA 4	
Trendi i ofertave elektorale 2009-2021	Faqe.....46
4.1. Ofertat elektorale dhe krahasimi mes partive	Faqe.....46
4.2. Sfidat nga pandemia dhe rindërtimi në premtimet elektorale 2021	Faqe.....51
PËRFUNDIME	Faqe.....55
SHTOJCA	Faqe.....58
PREMTIMET GJEDHORE TË PD, 2021	Faqe.....58
PREMTIMET GJEDHORE TË PS, 2021	Faqe.....73
PREMTIMET GJEDHORE TË LSI, 2021	Faqe.....85

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Me krijimin e POLIFAKLT.al, si pjesë e qenësishme e projektit *Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017* të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë është tashmë mundësia për të bërë prezente edhe vijimësinë e raportit *“BESUESHMËRIA DHE PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE 2021”*

Duke filluar nga muaji Mars 2021, bazuar edhe në monitorimet e kryera nga stafi i ALTAX, ekspertët tanë kërkojnë deklaratat për të kontrolluar faktet. Ne lexojmë transkriptime, fjalime, lajme, njoftime për shtyp dhe broshura fushatash. Ne shikojmë TV dhe skanojmë mediat sociale. Lexuesit na dërgojnë sugjerime përmes postës elektronike. Ne përgjithësisht i verifikojmë deklaratat dhe faktet e paraqitura nga lexuesit. Meqenëse nuk mund t'i kontrollojmë me lehtësi të gjitha premtimet, ne zgjedhim ato më të vlefshmet dhe më domethënëset për publikun.

Duke vendosur se cilat pohime do të verifikojmë, ne i konsiderojmë qasjet tona duke u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

– A është bazuar deklarata në një fakt që është i verifikueshëm?

Ne nuk kontrollojmë mendimet dhe ne e pranojmë që në botën fjalës dhe retorikës politike, ka hapësirë për hiperbolizime dhe deklarime të pasakta dhe të pavërteta.

– A duket deklarata e papërgjegjshme apo tingëllon e gabuar?

– A është deklarata domethënëse?

Ne shmangim keqkuptimet e vogla për premtimet që padyshim janë një gabim gjuhësor.

– A ka të ngjarë që deklarata të përcillet dhe të përsëritet nga të tjerët?

– A do ta dëgjonte ose lexonte një person tipik thënien dhe do të pyeste: A është e vërtetë?

Ne zgjedhim edhe deklarata në lidhje me temat që janë dhënë në lajme. Pa mbajtur krah, ne jemi përpjekur të zgjedhim faktet përkatëse për të kontrolluar deklaratimet nga të dy krahët politikë. Në të njëjtën kohë, ne më shpesh kemi verifikuar faktet mbi partinë, që mban pushtetin ose liderët që në mënyrë të përsëritur bëjnë deklarata që tërheqin vëmendje.

Çdo verifikim i fakteve është i ndryshëm, por në përgjithësi procesi ynë i raportimit përfshin sa vijon:

– një rishikim të asaj që verifikuesit e tjerë të fakteve kanë gjetur më parë;

– një kërkim të plotë në Google;

– një kërkim të bazave të të dhënave në internet;

– konsultime me një larmi ekspertësh;

– një përmbledhje të publikimeve, si dhe

– një rishikim përfundimtar të përgjithshëm të fakteve në dispozicion.

Ne theksojmë burimet kryesore të informacionit dhe dokumentacionin origjinal, nëse është i disponueshëm publikisht. Ne kërkojmë qasje të drejtpërdrejtë në raportet e qeverisë, studimet akademike dhe të dhëna të

tjera. Nuk është e mjaftueshme për ne, që të marrim diçka të dorës së dytë. Ne nuk mbështetemi në atë që na thotë një fushatë ose zyrtar i zgjedhur, sepse përpiqemi ta verifikojmë atë në mënyrë të pavarur.

Në rastet kur PoliFakt duhet të citojë raporte të lajmeve nga media të tjera që mbështeten në burime të paemërtuara, vërejmë se nuk mund të verifikojmë në mënyrë të pavarur raportimin e tyre.

PoliFakt vlerëson premtimin e secilit lider partiak në fushatën elektorale 2021 bazuar mbi ndjekjen e premtimeve për fushatën në mënyrë që të informojë edhe lexuesit se si e kanë përmbushur axhendën e tyre qeveritarët e zgjedhur, si dhe sa të vërteta dhe të besueshme janë premtimet e fushatës aktuale.

Ne i vlerësojmë premtimet e fushatës bazuar në rezultate të verifikueshme, jo në qëllime ose përpjekje. Ne e kemi përkufizuar një premtim si një deklaratë të mundshme të një veprimi ose rezultati që mund të verifikohet.

Raporti analitik *“BESUESHMËRIA DHE PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE 2021”* është realizuar në formën e hulumtimit bazuar te krahasimi shkaqeve.

1. Qasja dhe qëllimi i përdorimit të metodologjisë

Kjo metodë e hulumtimit kryesisht është bazuar te faktori i krahasimit., e cila përdoret në këtë studim analitik për të përfunduar ekuacionin shkak-pasojë midis dy ose më shumë të dhënave (premtimeve) për partitë politike përpara, gjatë dhe pas fushatës elektorale, ku një e dhënë është e varur nga e dhëna tjetër, por jo detyrimsht. Në analizën që trajtohet nga kjo metodologji do të përdoren premtimet e tri partive kryesore në vend, Partia Demokratike (PD), Partia Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

Në analizimin e të dhënave janë përdorur baza krahasimi në drejtimin e një qasje bazuar në aspektet ligjore, aspekte strategjike, programe në nivel kombëtar ekonomike dhe sektoriale, por pa patur domosdoshmërisht krahasim statistikor. Baza tjetër e krahasimit është përballja e premtimeve që lidhen me prekjen e parashikimeve të buxhetit në vlerën e përllogaritur (ose ashtu si është thënë nga drejtuesit politikë të partive). Këto të dhëna ose grupe të dhënash janë përdorur ashtu siç ekzistojnë në strukturën e tyre natyrale në burimet e të dhënave.

Analiza nuk është kufizuar në trajtime të fakteve statistikore të grupeve të të dhënave, por shtrihet në analizimin se si ndryshojnë ato ose grupet e ndryshme nën ndikimin e të njëjtave ndryshime. Ky hulumtim është kryer pavarësisht nga lloji i marrëdhënies që ekziston midis dy ose më shumë subjekteve politike. Analiza e të dhënave bazuar te strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale përdoret për të paraqitur qartë rezultatin e marrë duke përdorur këtë metodë sasiore të hulumtimit, duke u nisur nga fakti se dokumentet strategjike të një vendi marrin rëndësi të dorës së parë përtej qeverisë që e miraton, për vetë kohëzgjatjen dhe misionin që përmbajnë ato.

2. Metodatat kryesore e të dhënave

Metoda kryesore e marrjes së të dhënave për analizën është bërë bazuar te të dhënat kërkimore sekondare.

Kjo metodë përfshin mbledhjen e të dhënave sasiore nga burimet ekzistuese të të dhënave si interneti, burimet qeveritare, raportet studimore, burimet kërkimore mediatike, etj.

Hartimi dhe renditja e premtimeve të grumbulluara janë të përcjella me kujdes duke u bazuar te fjalimet kryesore dhe prezantimet e drejtuesve kryesorë të partive politike përgjatë gjithë fillimit të vitit 2021.

Studimi ka përfshirë shumicën e premtimeve kryesore dhe jo kryesore duke synuar që të paraqiten të gjitha citimet dhe premtimet e dhëna nga liderët kryesorë të partive.

3. Metoda e analizës së të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave të papërpunuara është kaluar në realizimin e filtrimit dhe më tej të analizës së këtyre të dhënave për të nxjerrë përfundime vlerësuese. Është e rëndësishme të përmendim se në këtë studim janë lidhur rezultatet me objektivin e hulumtimit duke përcaktuar edhe rëndësinë statistikore të rezultateve.

Është e rëndësishme gjithashtu të përmendim se në studim kemi marrë parasysh ato aspekte të hulumtimit, të cilat u morën në konsideratë në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe janë raportuar në këtë studim me ndryshimin midis asaj që ishte planifikuar kundrejt asaj që ka rezultuar në të vërtetë.

Me metodën e analizës statistikore midis grupeve të të dhënave është vijuar më tej duke krahasuar në çdo premtim me peshë ndikuese, për secilin sektor publik që merr fonde nga buxheti i shtetit apo ndikon në jetën e qytetarëve dhe bizneseve (ndryshimet ligjore). Bazuar te krahasimet e premtimeve të fushatës zgjedhore me Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) dhe Buxhetet vjetore është krijuar një seri të dhënash krahasuese, ku premtimi nga njëra anë (sipas ndarjes sektoriale) krahasohet me vlerën e përfshirë (ose jo) në PBA për periudhën në të cilën referohet premtimi duke theksuar edhe diferencën që rezulton midis vlerës së llogaritur të premtimit dhe hapësirës së buxhetit për shpenzim.

P.sh. nëse është premtuar që do të rriten rrogat e mësuesve nga viti 2022 me 40%-60%, atëherë do të bëhet llogaritja se sa i kushton buxhetit vjetor ky premtim në vlerë absolute. Më tej ky premtim krahasohet me parashikimin që gjendet në PBA 2021-2023, për të krahasuar vlerën e premtimit me vlerën që përcaktohet për këtë zë në sektorin e arsimit.

4. Burimi i të dhënave

Të dhënat e disponueshme në internet janë ato që janë shfrytëzuar gjerësisht duke cituar në çdo rast të përmendur si burim informacioni edhe linkun nga është marrë e dhëna/informacioni.

Me informacionin e bollshëm në faqet e ndryshme informative dhe statistikore është synuar që të përzgjidhen edhe burime të besueshme informative, pasi informacioni në lidhje me shumicën e temave të hulumtimit edhe pse është i disponueshëm mundet të ketë gabime apo pasaktësi. Kjo analizë kryqëzuese na ka ndihmuar në rritjen e vlefshmërisë së të dhënave kryesore sasiore dhe cilësore, si dhe në vlerësimin e rëndësisë së të dhënave të mbledhura.

Burimet qeveritare dhe joqeveritare të informimit janë përdorur gjithashtu lidhur me premtimet qeverisëse, por edhe të dhënat për Programin Buxhetor Afatmesëm, si dhe të dhëna të tjera statistikore dhe financiare, që janë grumbulluar si informacion i gatshëm për tu përdorur për analizën studimore të bazuar te krahasimi. Këto të dhëna janë konsideruar prej nesh si të besueshme dhe të thelluara duke i përdorur për të rritur vlefshmërinë e përmbajtjes të të dhënave kërkimore të studimit.

Informacione publike të marra nga mediat kryesore janë një burim i përdorur me masë në kryerjen e kërkimit, për arsyen se mediat e referuara janë ende në tregun mediatik një burim i besueshëm informacioni. Nisur nga fakti se mediat e shkruara kanë kopje të rëndësishme të të dhënave për premtimet që janë deklaruar janë analizuar dhe vlerësuar edhe këto informacione që përbëjnë një pjesë të përzgjedhjes së premtimeve 2021.

Ato janë një bazë me informacione dhe dokumente të vlefshme nga të cilat janë nxjerrë informacione, që kanë plotësuar ato që nuk mundeshin të gjendeshin me dy burimet si më lart.

5. Sqarimi i shmangieve dhe parregullsive

Nga analiza dalin edhe disa gjetje, se sa ndikojnë premtimet e partive në programet qeverisëse, si dhe devijimet që mund të ndodhin edhe nga vetë programet fillestare qeverisëse duke i krahasuar me programet buxhetore që janë zbatuar mbi 10 vitet e fundit. Një gjetje tjetër rezulton nga analiza e fakteve, se cila forcë politike e ka patur realizimin bazuar te premtimet e veta.

Shmangiet dhe gabimet janë pjesë e mundshme e analizës. Por, në llogaritjet e kryera kjo shmangie nuk arrin të abstragojë nga rrjedha e të dhënave bazë të buxhetit. Në gjithë llogaritjet e kryera është përdorur rrumbullakosja e vlerave.

Ne jemi të hapur të pranojmë komente dhe llogaritje, kur kanë burime dhe referenca të sakta duke na i dërguar në adresën tonë të emailit info@polifakt.al. Ne do të pasqyrojmë gabimin e korrigjuar duke vendosur edhe burimin e tij.

PJESA 1 - Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale në 2021

1.1. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale

Më 25 prill, në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Partia Socialiste kërkonte një mandat të tretë, kurse PD synonte ardhjen në pushtet pas 8 vitesh në opozitë. Partia Demokratike, hyri në garë me koalicionin "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", i përbërë nga Partia Demokratike, dhe disa parti të tjera të vogla. Lëvizja Socialiste për Integrim hyri në garë me listat e veta dhe bashkë me koalicionin e PD kërkuan fitoren për drejtimin e vendit për 4 vitet e ardhshme.

Në garë u futën edhe disa parti të reja, si: Nisma thurje, Lëvizja për Ndryshim dhe Bindja Demokratike. Palët hynë në këtë garë pasi ndryshuan Kodin zgjedhor, jo pa polemika. Socialistët arritën një marrëveshje në Këshillin Politik me opozitën jashtë parlamentare, por më pas miratuan në Kuvend, me votat e opozitës brenda Parlamentit, disa amendamente në Kodin Zgjedhor.

PS hyri në konkurrimin për mandatin e saj të tretë me sloganin "Shqipëria, e ardhmja jonë", ku këtë radhë nuk u përfshinë në listat e konkurrimit 35 personalitete të njohura politike të PS, ndërsa 21% e listës së kandidatëve për deputetë janë emra të rinj.

Edhe PD la jashtë konkurrimit rreth 11 figura të njohura politike dhe përfshiu në listat e saj të kandidatëve për deputetë prurje të reja, por në një përqindje më të ulët se PS. Ndërkohë, që lideri historik i PD-së, Sali Berisha, ishte pjesë e konkurrimit politik të 25 prillit.

LSI ka deklaruar në vijimësi se ajo, si forcë politike me ndikim në qeveri formimin do të rezultonte me surpriza në këto zgjedhje lidhur me rezultatet që priste të arrinte. Në të gjitha aktivitetet që zhvilloi LSI deklaroi, se është e angazhuar fuqishëm të largojë qeverinë "Rama 2" dhe pas 25 Prillit, LSI do të ketë një rol të rëndësishëm për politikë bërjen në Shqipëri.

LSI shkoi në zgjedhjet e 25 Prillit me lista të ndara nga koalicioni opozitar "Aleanca për Ndryshim", ndërsa me Partinë Demokratike ka një marrëveshje me të cilën koordinohet për përfaqësimin në qeverisje, nëse fitojnë në garën elektorale.

Ndërkohë, roli i Presidentit të Republikës, z. Meta në këto zgjedhje është në drejtim të mbrojtjes së votës dhe luftë ndaj krimeve zgjedhore. Zyra e tij e komunikimit hapi enkas në fillim të fushatës zgjedhore një dritare në faqen elektronike të institucionit me nismën "Denonco krimin zgjedhor", si dhe një thirrje publike qytetarëve, që shohin shkelje të së drejtës së votimit apo që dëmtim të procesit zgjedhor.

Presidenti Meta e konsideroi rrezikun e shitblerjes së votave si një kërcënim të pranishëm, ndërsa krimet zgjedhore mundet të shtrembërojnë vullnetin e zgjedhësve dhe të dëmtojnë demokracinë duke instaluar autokratët.

PS dhe PD kanë prezantuar qasje të ndryshme lidhur me pozicionimin e kandidatëve në ato pjesë të listave, që konsiderohen si "të sigurtë" për të dalë fitues dhe pjesës kryesisht të vjetër, ku fitorja është e rrezikuar. Qasja që pruri PS ishte vendosja në "zonën e sigurtë" kandidatët e rinj dhe vendosja (me disa përjashtime në disa qarqe) e drejtuesve politikë në fund të listave në qarqet kryesore, ku do të zhvillohej votimi.

PD pati një qasje tjetër, ku në krye të listave kishte caktuar figura politike, individë me kontribute politike.

PD, PS dhe LSI kanë respektuar kuotën gjinore. Gratë janë në një përqindje të konsiderueshme në "zonën e sigurtë" të listave të partive.

Të tri forcat politike kryesore bënë përpjekje për të lënë jashtë listës së kandidatëve për deputetë individë me rekorde kriminale në të kaluarën e tyre nën presionin e fuqishëm të BE dhe SHBA.

Në bazë të Kodit Elektorale, fushata për zgjedhjet parlamentare filloi më 25 mars, një muaj para zgjedhjeve. Por në fakt ajo kishte filluar prej javësh, ku të dyja palët kanë zhvilluar takime me target grupet e zgjedhësve duke dhënë premtime për dalje nga kriza e pandemisë dhe një Shqipëri me një ekonomi dhe edukim për brezin e ri më të mirë.

Ndryshimet lidhur me sistemin zgjedhor apo me rregullat e përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve janë disa nga azhornimet e bëra në Kodin Zgjedhor që ofrojnë më shumë garanci për integritetin e procesit zgjedhor. Ndryshimet konsistojnë në përdorimin e sistemit të identifikimit biometrik të zgjedhësve që është një garanci më shumë për integritetin e procesit të votimit, si dhe ndryshimet që reflektojnë mënyrën sesi do të mbikqyret veprimtaria e administratës publike, rregullat e reja të ndryshuara lidhur me raportimin e financave, përdorimin e fondeve publike.

Ndryshimet në Kodin Elektorale, të kryera në kuadër të reformës zgjedhore u japin shanse për të fituar edhe atyre që janë vendosur në pjesën e fundit, të pasigurtë të listës së PS. Nëse këta kandidatë ia dalin mbanë të marrin si individë mbi 10 mijë vota apo kur votat e marra prej tyre janë më të shumta se ato të kandidatëve në "zonën e sigurtë", pra në krye të listave, për ta ka shpresa të jenë në parlamentin e ri. Fakti që në pjesën dërrmuese në krye të listave janë emra të panjohur për elektoratin e bën më të lehtë fitoren e figurave të njohura të PS që janë vënë në fund të listës.

Procesi zgjedhor pati një ecuri me probleme të lidhura me shitblerjen e votës si dhe incidenti i rëndë i ndodhur në Elbasan, pak ditë përpara zgjedhjeve. Megjithatë, parë në krahasim me zgjedhjet e kaluara shikohet një konsensus për ruajtjen e qetësisë mes të gjitha palëve dhe aktorëve të interesuar. Kjo është pozitive, ku duket sikur në zgjedhjet e 25 prillit, të paktën në aspektin teknik, po shkohet me dakordësi të plotë të të gjitha palëve.

Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor ka pritshmëri të lartë se shit- blerja e votave do të reduktohet maksimalisht. Përveç kësaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), pati angazhim me një fushatë edukuese për zgjedhësit, si asnjëherë më parë, që filloi nga Shkurti dhe zgjati deri përpara datës së zgjedhjeve, lidhur me listat e zgjedhësve dhe dokumentat e identifikimit, me veprat penale në fushën e zgjedhjeve që lidhen me shit- blerjen, financimet e paligjshme shpërdorimet e fondeve publike, si dhe me mënyrat sesi do të votohet. Gjithsesi, mangësi edhe në këtë drejtim pati sipas konfirmimeve nga monitorimet në terren lidhur me publikimin e listave të zgjedhësve, posterave informuese, paisjeve identifikuese, si dhe ruajtjes së konfidencialitetit në votim.

Kodi Zgjedhor ka parashikuar që qytetarët shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të votojnë, por kjo e drejtë pati kufizime për arsye të ndalimit për të votuar për shtetasit që vinin nga Maqedonia e Veriut dhe Greqisë, për arsye karantinimi për dy javë pas hyrjes në Shqipëri. Po kështu edhe një numër i konsiderueshëm votuesish vlerësohet të mos kenë votuar për arsye të karantinimit të tyre nga shkaku i pandemisë. Ndërkohë, realizimi faktik për të mundur atë që një

ligji u pa si i pamundur të realizohej edhe për këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, pasi munguan një tërësi elementësh logjistike dhe rregullatorë për të mundësuar votimin e diasporës shqiptare me të drejtë vote.

Ambasadorja amerikane dhe ambasadorët e zyrtarët më të rëndësishëm të vendeve partnere me Shqipërinë kanë apeluar gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore të të gjitha partitë dhe udhëheqësit e tyre që të përfshihen plotësisht dhe me përgjegjësi në ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tyre. Shefi i Delegacionit të BE-së, Luigi Soreca, dhe përfaqësuesit e 27 misionëve të shteteve anëtare të BE-së në Shqipëri, publikuan një deklaratë të përbashkët, ku theksuan se partitë politike dhe kandidatët duhet t'i përqendrojnë debatet e tyre tek programet politike dhe reformat, që synojnë të paraqesin për të përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve.

Fushata zgjedhore u kushtëzua dukshëm nga rregullat mbrojtëse të pandemisë Covid-19 edhe pse ato nuk u respektuan sipas vendimeve të Komitetit të Ekspertëve nga të gjitha forcat politike njësoj. Gara e tubimeve të mëdha, se cila forcë politike mund të mbledhte më shumë përkrahës në sheshe u zhvendos në një pjesë të madhe edhe nëpër monitorët elektronikë që publikonin aktivitetet e partive në rrjete sociale si dhe në faqe interneti. Nga vëzhgimet në terren për monitorimin e premtimeve zgjedhore ne arritëm të kemi një panoramë të plotë të aktivitetëve dhe programeve politike të partive kryesore.

1.2. Analiza paralele/ tematike nga të tjera organizata për premtimet 2021

Në zgjedhjet e 2021 janë angazhuar në monitorimin e premtimeve zgjedhore të politikanëve shqiptarë disa portale mediatike dhe organizata jo fitimprurëse. Ne kemi studiuar disa prej tyre, me qëllimin për të evidentuar në radhë të parë gjithë premtimet e bëra nga drejtuesit dhe zyrtarët e lartë politikë të partive. Nga ana tjetër, një angazhim më i drejtpërdrejt është bërë për qëllime të matjes së besueshmërisë dhe vërtetësisë së premtimeve të bëra nga deklaratimet e liderëve partiakë.

Qëndresa Qytetare është në vijimin e monitorimeve që ka nisur me premtimet e bëra nga qeveria "Rama 2" lidhur me sektorin e edukimit. Kjo organizatë është e përkushtuar kryesisht në monitorimin edhe për zgjedhjet e vitit 2021 me premtimet e politikanëve për edukimin, mirëqeverisjen, antikorrupsionin si dhe në përgjithësi angazhimin e të rinjve në pjesëmarrje ndërgjegjësuere lidhur me rolin e madh që ata kanë për të bërë ndryshimin e nevojshëm prej politikës së vjetër.

Faktoje është një tjetër portal i njohur për analizat dhe argumentet lidhur me premtimet e politikës në Shqipëri. Ky portal është i angazhuar dhe publikon nëpërmjet ëëë.faktoje.al analizat dhe ballafaqimet që realizon rrjeti i vet i ekspertëve për gjithë premtimet e bëra nga liderët në vitin 2021. Kjo organizatë mediatike është ngritur mbi parimin e gjurmimit dhe provës nëpërmjet fakteve të gjithë premtimeve duke vlerësuar nëpërmjet gjetjeve të veta edhe besueshmërinë e premtimeve dhe programeve zgjedhore.

Together for Life (TFL) është një tjetër organizatë jo fitimprurëse e angazhuar në matjen dhe vlerësimin e programeve për sektorin e shëndetësisë të partive politike garuese në zgjedhjet e vitit 2021. Së fundmi, TFL zhvilloi një studim krahasues mbi premtimet e partive politike në sektorin e shëndetësisë gjatë fushatës zgjedhore. Autorët e studimit thonë se partitë politike hynë në fushatë me strategji të cunguara për zhvillimin e shëndetësisë.

1.3. Vendimet e Qeverisë dhe Ligjet e miratuara në prag fushate

Në kuadër të ruajtjes së një etike, në respekt të barazisë së garës zgjedhore përpara fillimit të fushatës, ekspertët e POLIFAKT.al kanë analizuar gjithë publikimet zyrtare, të cilat i paraqesim më poshtë.

“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet **propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore**, të cilat parashikojnë *dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë*, të tilla si aktet që parashikojnë (a) rritjen e pagave, pensioneve,(b) mbështetjes ekonomike apo sociale,(c) uljen ose heqjen e taksave,(d) vendosjen e amnistive fiskale,(e) privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj.,përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.” Kodi Zgjedhor 2021, Neni 91, pika 4¹.

Ndërsa Kodi Zgjedhor shprehet qartësisht për ndalimet që prekin ligjin dhe etikën e zgjedhjeve nga monitorimi I bërë publikimit të akteve të ndryshme në Fletoren Zyrtare konstatohen këto raste të vendosura sipas datës së publikimit të tyre.

30/12/2020

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1076, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar²

- *Me miratimin e vendimit nr. 1076, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave përfitojnë rreth 20000 punonjës të sistemit shëndetësor në të gjitha institucionet që kryejnë funksione shëndetësore, si në nivel terciar ashtu edhe atë sekondar, bashkiak dhe në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor që e shtrijnë veprimtarinë në territorin e vendit.*

08/01/2021

2. Ligj nr. 156/2020, date 17.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016;³

- *Ky ligj bën falje detyrimesh të ushtarakëve, që në periudhën parazgjedhore ndalohet si një amnistim (falje) fiskale.*

3. Ligj nr. 164/2020, datë 23.12.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar;

- *Shtyhet afati i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme me normë tatimore të reduktuar deri në datën 31 dhjetor 2021.*

4. Ligj nr. 165/2020, datë 23.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9179, date 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

¹ <https://www.osce.org/files/f/documents/5/7/477547.pdf>

² <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/233/0c4afe98-ea52-4e67-8f2c-10ef89e88e7b>

³ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/3/6531eb82-4b24-4ea3-9d84-081dac73b9c4>

- Përfitojnë trajtim të veçantë punonjësit e ndërmarrjeve të sistemit të industrisë ushtarake.

5. Ligj nr.167/2020, datë 23.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, që ish - punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfutur, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar;

- Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara që gjithë ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”.

6. Ligj nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore;

- Ky ligj njeh si periudhë të sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga mosha për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

7. Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 1146, datë 24.12.2020” Për dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit për pasurinë nr.109, me emërtim “Sh.a.Riparim artilerie”, e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43.169 m2, dhënë me kontratë me çmimin 1 euro/kontrata fondacionit “Fundjavë ndryshe”.

- Ky vendim jep pasuri publike në prag fushate një organizate private.

13/01/2021

8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.⁴

- Nga miratimi i vendimit nr. 1149, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave përfitojnë:
(a) 30.119 punonjës të institucioneve të arsimit parauniversitar në varësi të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve
(b) 1.349 punonjës të institucioneve të arsimit profesional, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
(c) 4.410 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe të konvikteve shkollore, në varësi të njërive të vetëqeverisjes vendore

19/02/2021

9. Ligj nr. 151/2020, datë 17.12.2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”,
të ndryshuar;

- Ky ligj ka të bëjë me heqjen e taksës nacionale të rentës minerare për vitin 2021, e cila bëhet zero.

10. Ligj nr. 168/2020, datë 23.12.2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar;

⁴ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/5/28f36109-f011-4360-876d-c2019bc93507>

- Ky ligj ul taksën doganore për mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz”, nga 15 për qind bëhet 2 për qind

11. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 17.2.2021 “Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, për portin në Triport, Vlorë⁵

- Vendimi jep të drejtë MIE për negociim të kontratës koncesionare/PPP në prag fushate zgjedhore.

16/03/2021

12. Ligj nr. 16/2021, datë 8.2.2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncesionare “Tirana International Airport” sh.p.k., “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë”, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, të ndryshuar. 6

- Nëpërmjet nëshkrimit të kontratës së re ka ndryshuar pothuajse pjesë të rëndësishme të tekstit të kontratës së mëparshme duke u konsideruar se në rast ndryshimi të një pjese të madhe të saj është në kuadrin e një Kontrate me terma ndryshe nga ajo egzistuesja.

13. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.163, datë 17.3.2021 “Përkalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të portit të peshkimit në Triport, Vlorë ⁷

- Ky vendim është në funksion të VKM nr. 100, datë 17.2.2021 “Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, për portin në Triport, Vlorë.

26/03/2021

14. Ligj nr. 27/2021, datë 1.3.2021 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania” sh.p.k. dhe “Rapiscan Systems” INC, “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, të ndryshuar.⁸

- Miratimi i ligjit ka lidhje me vijimësinë e koncesionit të kundërshtuar me forcë nga Partia Socialiste në zgjedhjet e vitit 2013 dhe në vijimësi, por që është edhe një kontratë e re në kohën kur pritet të fillojë fushata zgjedhore

31/03/2021

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”⁹

- Miratim rritje pensionesh për gjithë kategoritë e pensionistëve, në masën 2.7 për qind.

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/27/c98f3905-ad69-424a-b002-bf13085c05e6>

⁶ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/41/4526fccb-3412-47bc-ab2c-fe31ed2b5e9d>

⁷ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/46/c1c9b6ea-105d-4105-bae9-ccaa55e12ccc>


⁸ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/47/00c51072-02c2-457f-a404-686d57d3939e>

⁹ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/53/a883ec93-1eb5-4ea3-aa4b-f9cf1a9c581d>

PJESA 2 - Premtimet e partive kryesore politike

Nga monitorimi i premtimeve të deklaruara nga drejtuesit e lartë të tre partive kryesore të vendit, duke filluar monitorimin nga data e përcaktuar sipas Kodit Zgjedhor¹⁰ dhe deri në ditën kur ky Raport ka kaluar për publikim është konstatuar se janë bërë 298 premtime nga të tre partitë së bashku. Ky numër premtimesh është i njëjtë me sasinë e premtimeve të deklaruara në vitin 2009¹¹.

Premtimet specifike dhe të përgjithshme në Zgjedhjet 2021



Partia Demokratike (PD) ka bërë 130 premtime. Partia Socialiste (PS) ka bërë 108 premtime. Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) ka bërë 60 premtime.

Nisur nga ndarja sipas orientimit sektorial të premtimeve¹², ato janë kategorizuar në 13 grupe sektoriale, duke filluar nga arsimi, gruaja, rinia, shëndetësia, ekonomia, mjedisi e turizmi e duke vazhduar me bujqësinë, politikën e jashtme, energjinë, infrastrukturën e transportin, politikën fiskale dhe politikën sociale dhe duke e mbyllur

me premtimet politike dhe ato që adresojnë tematika të përgjithshme dhe kryesisht nuk përfaqësojnë linja ministrore.

Nëpërmjet analizimit në brendësi të premtimeve, por edhe funksionit që ato kërkojnë të përmbushin, ashtu si shihet edhe në Grafik një masë prej 89% e premtimeve të tri partive janë të natyrës specifike, pra premtime që kanë një fokus të orientuar qartë, ndërsa 11% e premtimeve janë të natyrës së përgjithshme dhe kanë fokus me shtrirje në gjithë vendin apo për gjithë grupet shoqërore dhe votuesit. Në një krahasim me zgjedhjet e fundit në 2017, ka një rënie të nivelit të premtimeve specifike me 3%. Nëse e krahasojmë me mesataren e premtimeve specifike të tre zgjedhjeve të fundit ky nivel është me 4% më poshtë.

PD ka nivelin më të ulët të premtimeve specifike (82%), kryesisht nga numri më i madh i premtimeve në këto zgjedhje. Niveli specifik i premtimeve të PS është 94 % dhe LSI e ka 93%.

Në gjithë këtë mori premtimesh në vitin 2021 shikohet se ky tregues na shfaq një anë të shndërrimit gradual të politikës shqiptare në këto vite të fundit në forca politike, që kërkojnë më shumë se më parë populizmin dhe premtimet në adresë të problematikave që shqetësojnë votuesin e pavendosur.

¹⁰ Fushata filloi më 25 Mars 2021

¹¹ 298 premtime të konstatuara

¹² sipas ndarjes që gjendet edhe te www.polifakt.al

Në Tabelën mëposhtme që përmbledh gjithë premtimet zgjedhore në 2021, sipas sektorëve të jetës së vendit

PREMTIMET ZGJEDHORE TË TRE PARTIVE KRYESORE NË 2021

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2021	PD	PS	LSI
1	Arsimi	17	18	15
2	Gruaja dhe Rinia	3	1	3
3	Shëndetësia	8	10	3
4	Ekonomia	6	12	12
5	Mjedisi dhe Turizmi	9	7	2
6	Bujqësia	12	6	8
7	Politika e Jashtme	6	1	0
8	Energjia	19	9	2
9	Infrastruktura dhe Transporti	2	24	1
10	Fiskale dhe buxheti	13	10	7
11	Politikë	7	2	2
12	Politika sociale	11	3	3
13	Të tjera (administrata, dixhitalizimi, arti etj.)	17	5	2
NUMRI I PREMTIMEVE GJITHSEJ		130	108	60


Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

ka një konkurrueshmëri të fortë premtimesh midis partive në drejtim të arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, turizmit dhe politikave fiskale.

Vërehet një vëmendje sektoriale më e shtuar se partitë e tjera nga PS në premtimet për infrastrukturën dhe transportin. PD ka një vëmendje më të shtuar të premtimeve drejt proceseve të integritit, politikave sociale dhe administrimit, antikorrupsionit, shtresave sociale të pronarëve dhe ish-të persekutuarve të regjimit të kaluar.

Ndërkohë, kur krahasojmë premtimet e partive sipas destinacionit të tyre, nga analiza horizontale sipas Grafikut më poshtë duket se PS dhe LSI i kanë përdorur respektivisht 14% dhe 20% të premtimeve të tyre në drejtim të edukimit, gruas dhe rinisë, ndërsa PD ka një përdorim më të pakët të premtimeve (9%) në drejtim të këtij sektori, kur në daljet publike të tre partitë i vënë theksin në mënyrë të veçantë.

Premtimet zgjedhore sipas destinacionit, 2021



PD e ka hartuar pjesën më të madhe të premtimeve dhe i ka përfshirë në programin e saj zgjedhor ato pika që destinohen për buxhetin, politikat lehtësuese tatimore dhe energjinë (42%) dhe pjesa tjetër e premtimeve (58%) ka një shpërndarje të baraspeshuar nëpër gjithë sektorët e tjerë.


PS i ka hartuar pjesën më të madhe të premtimeve në drejtim të buxhetit dhe politikave lehtësuese tatimore, arsimit, infrastrukturës dhe transportit (56%) dhe pjesa tjetër e premtimeve (42%) me destinim

në sektorët e tjerë ka një adresim të baraspeshuar të premtimeve të përfshira në Planin e Veprimit 2021-2025.

LSI është fokusuar në hartimin e programit të saj elektoral në drejtim të premtimeve për ekonominë, politikën lehtësuese fiskale dhe buxhetin, si dhe arsimin (63%). Pjesa tjetër e programit të premtimeve (37%) është destinuar në sektorët e tjerë të vendit, por duke u treguar racionale me numrin e premtimeve dhe duke mos premtuar asnjë gjë për politikën e jashtme, kulturën e artin dhe antikorrupsionin.

Nga gjithë analiza krahasuese e programeve të premtimeve elektorale të partive, pavarësisht emërtimeve të tyre nuk kanë një qasje të përbashkët, përveç premtimeve për lehtësitë fiskale dhe alokimet buxhetore, që respektivisht për PD, PS dhe LSI kanë një pjesë në raport me totalin e premtimeve të tyre me 29%, 31% dhe 30% (shih te Grafiku).

Premtimet buxhetore dhe fiskale të tre partive kryesore, 2021



Për të rivendosur besimin e publikut nuk mjafton që të bëhen premtime në masë të madhe për transferta buxhetore dhe lehtësi fiskale të shpeshta. Ajo që vlen në këto raste është ekuilibrimi i pritshmërive të qytetarëve në momentin që premtohet nga partitë, sipas mundësisë dhe kapaciteteve qeverisëse dhe buxhetore. Kur qytetarët presin më shumë nga një qeveri në raport me atë që ajo mund të japë në mënyrë efektive, ata e humbasin sigurinë me politikanët dhe institucionet politike.


Në prirjet e premtimeve zgjedhore të vitit 2021 nuk gjendet hapësira për të ulur pritshmëritë e larta të qytetarëve nga buxheti nëpërmjet uljes së premtimeve për transferta buxhetore. Nga ana tjetër duhet të shtohen premtimet që lidhen me përmirësimin e kapacitetit të qeverisë duke përmirësuar performancën dhe duke zgjeruar gamën e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme ndaj kohës. Të gjithë do të duhet të zhvendosin disa rreziqe dhe kosto në të ardhmen nisur nga koha me kriza financiare dhe shëndetësore që gjendet te pragu i secilit votues.

Megjithatë, sipas premtimeve të partive në vijim duket se ato priren të deklarohen me premtime të thjeshta dhe të lehta për tu përmbushur, për të mos u ndodhur përballë faktit të mospërmbushjes dot të tyre.

2.1. Premtimet e Partisë Demokratike

Pikat më të forta në programin elektorale të PD janë *punësimi dhe politika e jashtme*, ku përfshihet edhe integrimi, por të pasuara në mënyrë shumë të fortë mbështetëse nga propozimet për buxhetin dhe lehtësitë tatimore. Në një pamje të parë Grafikut që paraqet gjithë premtimet e PD-së, sipas ndarjes sektoriale është dukshme kolona e premtimeve buxhetore dhe lehtësive tatimore me numrin më të lartë (38 premtime). Kjo sasi e madhe e premtimeve buxhetore përmbledh premtimet për secilin nga sektorët e tjerë, por që për nga natyra e premtimit konsiderohet si financiare. Ndërkohë, një numër i madh premtimesh është adresuar te sektori i energjisë, i cili përfshin si politikat për mbështetje energjetike të vendit, po ashtu edhe politikat për gazifikimin dhe rigjallërimin e industrisë hidrokarbure dhe rritjen e cilësisë dhe uljen e kostos së karburanteve për automjetet. Premtimet për këtë sektor janë tejet sfiduese për tu realizuar në rast se do të kthehen në program qeverisës.

PD - Premtimet sipas sektorëve 2021 (numër)



Premtimet për arsimin, mjedisin e turizmin, si dhe aspektin rregullator dhe administrativ të funksionimit të vendit janë në një numër të njëjtë duke marrë në konsideratë se kjo vëmendje do të vijojë të jetë me këtë intensitet edhe në rast të një program qeverisës në të ardhmen.

Premtimet për arsimin, gruan dhe rininë janë të orientuara drejt rritjes së mbështetjes buxhetore për mësuesit dhe pedagogët në të gjithë sektorin, si dhe drejt orientimit të arsimit të teknologjia dhe inovacioni. Nga njëra anë, përpiqet të lehtësohet barra e familjeve në nevojë me anë të premtimit të teksteve shkollorë falas dhe pajisjeve kompjuterike, si dhe një qasje të re drejt arsimit profesional dhe gjithpërfshirjes në sistemin e arsimit të gjithë nxënësve të arsimit para universitar. Nga ana tjetër, studentët do të stimulohen nëpërmjet subvencioneve për studimet e tyre. Por, një premtim specifik është *abrogimi i ligjit për arsimin e lartë*, i cili synon të jetë në ndihmë të optimizimit të votës së studentëve protestues dy vite më parë, që kryesisht kundërshtuan edhe këtë ligj.

Megjithatë, nismat e premtimeve për abrogime të ligjeve janë një rast tipik i mungesës reale të përgjegjshmërisë financiare, pasi asnjëherë në këto zotime nuk prezantohen kostot që shoqërojnë vendime politike të tilla.

E njëjta qasje vihet re edhe në premtimet për shëndetësinë, ku nga njëra anë premtohet rritja e ndjeshme e mbështetjes buxhetore për gjithë punonjësit e sektorit, por nga ana tjetër premtimet adresohen edhe te nevojat bazë të përdoruesve të medikamenteve duke premtuar adresimin për zgjidhje brenda mandatit të gjithë mosarritjeve të derisotme.

Fokusi i premtimeve për turizmin dhe bujqësinë është drejt lehtësimeve tatimore, transfertave buxhetore dhe mundësisë për zgjerim të tregut të tyre, por pa orientuar një zgjidhje të qartë për modelin ku do të harmonizohen dhe rritin konkurrueshmërinë këta sektorë të lidhur ngushtë me njeri-tjetrin.

Në këto zgjedhje, infrastruktura nuk është një nga pikat e forta të premtimeve të PD-së.

Shpjegimet konvencionale për premtimet më të pakta në numër për pronat, kulturën dhe posaçërisht për investimet në infrastrukturë dhe transport, duket se lidhen sa me pamundësitë për të arritur rezultate të shpejta brenda mandatit, por kryesisht ato mbështeten në argumente të anës së furnizimit, ku aktorët qeveritarë ose institucionet nuk arrijnë të sigurojnë llojet e shpenzimeve që duan shumica e votuesve në rastin e infrastrukturës.

Ndërkohë, nisur nga premtimet e mëdha për infrastrukturën në zgjedhjet e kaluara dhe rezultati i përgjithshëm zgjedhor në rënie kanë ndikuar në mos përsëritjen e të njëjtave qasje, që me sa duket nuk kanë orientuar një rezultat zgjedhor të pritshëm.

2.2. Premtimet e Partisë Socialiste


Në analizën e premtimeve të PS, që u është adresuar votuesve të saj duket se synon të racionalizojë mënyrën e adresimit në Planin e Veprimit 2021-2025 të rigarantimit të premtimeve elektorale në drejtim të preferencave të votuesve për temat që përfshijnë politikën sociale, legalizimet dhe pronat, antikorrupsionin, politikën e jashtme dhe bujqësinë. Premtimet e pakta drejt këtyre sektorëve duket se tentojnë të ulin fokusimin e votuesve me besim të ulët, që presin prej shumë vitesh nga të gjitha qeveritë një vëmendje dhe forcim të kapaciteteve rregullatore.

Premtimet buxhetore janë pjesa më e prekshme nga totali i premtimeve dhe përfshijnë sektorë të rëndësishëm të programeve të PS, të tilla si: arsimi, infrastruktura (përfshirë rindërtimin), dixhitalizimi. Ndërkohë, një numër i madh i premtimeve për këta sektorë është më shumë i orientuar drejt tërheqjes së vëmendjes së votuesit të ri, që më së shumti përmbledhet te kategoria e studentëve, votuesve për herë të parë që u ofrohet shumë më tepër arsim profesional se në zgjedhjet e kaluara. Një orientim tjetër i premtimeve për arsimimin është te kategoria e prindërve që arsimojnë fëmijët e tyre në ciklin arsimor 9-vjeçar. Kësaj kategorie votuesish u ofrohet lehtësi logjistike dhe infrastrukturore për lehtësimin e procesit të arsimimit, por edhe duke u dhënë shpresë me zotimet për krijimin e një gjenerate të re të bazuar te zëjtaria dhe inovacioni. Në tërësi premtimet për arsimin kanë synim të jenë më gjithëpërfshirëse se premtimet e kundërshtarëve politikë, duke synuar që nëpërmjet numrit të madh të tyre të prekin çdo aspekt të jetës dhe kushteve mësimore.

Premtimet për shëndetësinë janë më së shumti të lidhura me financimet dhe prokurimet për të mira publike infrastrukturore (spitale dhe qendra shërbimi mjekësore bashkë me teknologjinë) dhe kanë shprehur qasjen për rimodelimin financiar të sektorit, por pa thënë qartë se si do batohet dhe çfarë do të ketë si efekt në lidhje me sektorët e tjerë. Duket se premtimet janë një vijimësi e programit buxhetor në proces, por me një mungesë të premtimeve lidhur me finalizimin e shëndetësisë falas, përveç pjesës së financimit të saj.

Ekonomia është në vëmendjen e premtimeve, por me një qasje që synon të arrijë përmbushjen e premtimeve të zgjedhjeve të kaluara, pa prurë të reja lidhur me modelimin ekonomik të Shqipërisë në 4 vitet e ardhme, si dhe duke u orientuar si edhe për sektorët përbërës të ekonomisë drejt investimeve logjistike industriale zonale (p.sh. park industrial në Lezhë).

PS - Premtimet sipas sektorëve 2021 (numër)



Ndërkohë, turizmi, por edhe bujqësia nuk duket se kanë një vëmendje të posaçme, përtej asaj që premtohet si një orientim i veçantë i lidhur me zhvillimin e agroturizmit. Angazhimet politike, shihet se nuk e kanë ende këtë sektor të gjerë ekonomik si një pjesë me rëndësi të premtimeve, por shihet më shumë se ky sektor duhet ta lidhë fatin e tij me lehtësi fiskale dhe transferta buxhetore, por pa dhënë vizionin që përshkruan strategjia sektoriale e miratuar së fundmi, apo qasje vizionesh të propozuara nga opozita dhe diaspora. Ky sektor që është e nevojshme ti kushtohet një rëndësi e posaçme për arsye të pasurive natyrore të vendit nuk është ende pjesë e një masterplani të pranuar nga të gjitha palët politike, nga ku nuk mund të ketë vizione të ndara, por një politikë solide dhe e qëndrueshme. Kjo qasje mungon në premtimet e krahëve të politikës.

Energjia është në këto zgjedhje me premtime që synojnë të shfaqin vijimësi të konsolidimit të politikave të mëparshme dhe që duhet të bazohen në qëndrueshmëri dhe rritje të investimeve. Në fakt, mungojnë në premtimet e PS sektori që lidhet me hidrokarburet, gazifikimin si dhe pjesën e përmendur nga shumë organizata biznesi për cilësinë dhe tregun e karburanteve në tërësi. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë premtim që të lidhet me administrimin e sektorit lidhur me fatin e koncesioneve që prekin direkt ardhmërinë afatgjatë të sektorit energjetik, nisur nga fakti se kontratat e HEC-eve private kanë hyrë në një periudhë maturimi të tyre.

Nga ana tjetër, niveli i lartë i premtimeve buxhetore, infrastrukturore janë një vijimësi e programeve zhvillimore të qeverisjes dhe buxheteve të miratuara për zbatim në periudhë afatmesme. Premtimet për infrastrukturën duket se janë të ndara sa nga mbështetja e programeve direkt nga buxheti, po aq edhe nga kontratat koncesionare apo në partneritet privat-publik, përse premtohet për infrastrukturën aeroportuale. Në fakt, gjithë premtimeve i mungon fatura e specifikuar për secilin prej tyre duke sqaruar se sa do të paguhet në 4 vitet e ardhme, si dhe sa do të paguhet në periudhën e Shqipërisë 2030. Premtimet

infrastrukturore, në gjithë vendet që janë pjesë e BE-së shoqërohen me kostot përkatëse dhe specifikat e mundshme të kohëzgjatjeve sipas projekteve të bazuara në raportet e fizibilitetit të bëra nga prokuruesit e tyre. Në premtimet e PS kjo qasje mungon dhe krijon vetëm një besim te votuesi për përmbushje të tyre bazuar në besimin te individi dhe jo kostoja ekonomike apo qartësia e realizimit të veprës dhe mënyrës së financimit.

Ndër premtimet në adresim të problemeve sociale shikohet një premtim, që nuk është traditë e PS lidhur me dyfishimin e fondit për kreditë e buta të familjeve, kur në fakt kjo politikë është e lidhur edhe me politikat monetare dhe tregun financiar shqiptar ku qeveria është pjesëmarrëse, por jo vendimmarrësja e vetme.

Ndërkohë, duket se premtimet për votuesit janë orientuar edhe drejt konsolidimit të rindërtimit, ku dallohet premtimi për përfundimin e rindërtimit të rreth 12 mijë apartamenteve dhe rehabilitimi i 160 objekteve arsimore brenda vitit 2022. Ndërkohë, edhe pse shpenzimet për përballimin e efekteve nga pandemia Covid-19 nuk duket se do të jenë të vogla, PS edhe pse ka dedikuar një pjesë të madhe të kohës së fushatës zgjedhore me përballimin e kostove prej Covid-19 duket se nuk ka synuar ta kthejë në një objekt premtimesh zgjedhore, që me një logjikë të ftohtë qeveritari duket se zhdukja e pasojave të pandemisë nuk është premtim i lehtë për tu mbajtur dhe përmbushur.

Kriza shëndetësore që thelloi krizën ekonomike është ende pjesë e jetës në vitin 2021 kërkon një përgjigje të plotë publike dhe private, duke filluar me qeverinë që duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme për gjithë efektet e krijuara në ekonominë e vendit dhe atë familjare, por duke siguruar edhe mbështetje logjistike për të bërë efektive administratën në reflektim të kushteve të reja të ndërveprimit mes shtetit dhe biznesit.

2.3. Premtimet e Lëvizjes Socialiste për Integrim

Nën presionin e vazhdueshëm si një parti e vogël, e cila synon të qeverisë në koalicion me PD dhe aleatët e tjerë të së djathtës, LSI në premtimet e deklaruara në zgjedhjet e vitit 2021 synon të përçojë optimizëm të bazuar në programin zgjedhor prej 5 pikash që përmbledh qasjen për formalizim nëpërmjet politikës së rimbursimit të konsumit, të zerimit të TVSH për prodhimet e sektorit të bujqësisë, me qasjen drejt arsimit profesional dhe rritjen e infrastrukturës arsimore, si dhe me nxitjen e politikave të anti-shpopullimit të vendit nëpërmjet programit për stimulimin e lindshmërisë në vend. Nga ana tjetër, premtimet e LSI, të cilat janë më pak se gjysma e numrit të premtimeve të PD i adresohen një elektorati, i cili ka pritshmëri për zgjidhje të shpejta dhe praktike për t'i dhënë fund krizës.

Premtimit për arsimin, gruan dhe rininë tregojnë një fokus në rritje krahasuar me vitin 2017. Programi elektorale për arsimin është bazuar, sa te premtimi i madh dhe i përsëritur prej zgjedhjeve të kaluara (2013 dhe 2017)¹³, por edhe te premtimet për arsimin profesional duke dhënë edhe zgjidhjen e financimit të tij nëpërmjet futjes së një takse të re, të quajtur taksa e të ardhmes¹⁴. Një adresim tjetër i premtimeve drejtuar rinisë, si pjesa që përbën vitalitetin e elektoratit të LSI-së janë ulja e kostos së studentëve dhe rritja e rolit të tyre në vendimmarrje. Premtim i veçantë në këto zgjedhje për mësuesit është ai lidhur me miratimin e Statusit të Mësuesit. Prindërve të nxënësve të ciklit arsimor 9-vjeçar u është premtuar lehtësimi prej kostos


¹³ për rritjen e buxhetit të arsimit në 5% të PBB, ku përfshihet infrastruktura arsimore si edhe premtimi më i kushtueshëm në këtë fushatë zgjedhore për dyfishim të pagave të mësuesve, kurse në zgjedhjet e vitit 2017 është premtuar rritje 50% e pagave

¹⁴ 1% e fitimit të biznesit të madh

së teksteve për fëmijët e tyre, por që duket se është një premtim që ka konsensusin e të tre partive, të cilat e kanë përfshirë në zotimet e tyre.

Shëndetësia në këto zgjedhje nuk ka premtimet e mëdha buxhetore që u bënë nga LSI në vitin 2017, duke u mjaftuar me disa konkretizime që maksimalizojnë votën e pritshme te elektorati i periferisë së Tiranës, me premtimin e ndërtimit të një spitali në Kamëz. Ndërsa, premtimet për politikën shëndetësore janë në sinkron me ato që ka premtuar PD, për një rimodelim të sektorit dhe dhënie fokusi te shërbimi parësor.

LSI - Premtimet sipas sektorëve 2021



Ekonomia shihet si pjesa më kulmore e premtimeve të LSI, ku në dallim nga partitë e mëdha gjejmë zotimin për një formalizim të ekonomisë dhe për krijimin e zonave të lira ekonomike me projekte zhvillimore të prezantuara gjatë fushatës për zona specifike ku ndodhet edhe një elektorat besnik ndaj LSI-së, në Berat dhe Durrës. Një premtim që tenton të sensibilizojë kryesisht familjet e varfëra është angazhimi për pagë shtesë në fund viti, që duket se zëvendëson pagesat që jepen për pensionistët për fund viti, apo paga e trembëdhjetë, duke konkuruar me oferta të ngjashme si p.sh. paketa e solidaritetit nga qeveria “Rama 2”.

Në premtimet ekonomike një vend të veçantë mban zotimi për mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në teknologji dhe inovacion, nëpërmjet programit “Garancia rinore”. Premtimet për ekonominë, me larminë e grupeve dhe shtresave që synojnë të nxitin për mbështetje politike janë orientuar edhe drejt mbështetjes së industrisë ushqimore dhe në përgjithësi prodhimeve “Made in Albania”, që në fakt janë një përsëritje e premtimeve të bëra edhe në zgjedhjet e kaluara.

Një premtim i përbashkët edhe me PD është adresuar te pjesa e zhvillimit të turizmit të gjuetisë, nëpërmjet heqjes së Moratoriumit të Gjuetisë. Ky premtim synon të nxitë interesin për banorët që mbahen me gjuetinë, por nga ana tjetër paraqitet edhe si një nxitje për turistët e huaj që do të rritin konsumin e zonave të mbrojtura deri më sot me këtë ligj.

Premtimet për bujqësinë dallohen për specifikën e instrumentit që lehtëson barrë fiskale dhe burokratike, nëpërmjet “Kartës së Fermerit”. Por, LSI zotohet përpara elektoratit të saj edhe për dhënien e certifikatës së tokës brenda dy viteve të para të qeverisjes së saj në koalicion me PD, si dhe uljen e kostos për fermerët nëpërmjet lehtësive fiskale dhe mbështetjes me instrumente financiarë. Këto premtime, bashkë me premtimin për trefishimin e prodhimit blegtoral janë dukshëm jashtë objektit të përgjegjshmërisë financiare, për arsye të pamundësisë së realizimit nga angazhimi ligjor e administrativ (certifikata e pronësisë), por edhe për pamundësi reale të buxhetit në lidhje me stimulimin për arritjen e objektivave me rritje 300% të treguesve të prodhimit privat.

Ndërkohë, duket se sektori energjetik nuk ka një fokus të caktuar nga LSI, përderisa premtimet janë një përsëritje e premtimit të PD për cilësinë e karburantit, por që nisur nga fakti se fushatat elektorale të dy partitë i bëjnë të ndara nuk duket se ky premtim identifikon LSI nëpërmjet deklarimit të këtij premtimi si dhe ai i ruajtjes së energjisë dhe antisizmikës në ndërtim.

Premtimet fiskale janë pjesa më e madhe e premtimeve, por që përgjithësisht janë një sinkron i premtimeve të PD-së, apo një përsëritje e premtimeve nga fushatat zgjedhore të kaluara.

Premtimet për mbështetje të politikave sociale përfaqësohen vetëm nga politika për të ndaluar shpopullimin nëpërmjet programit “Nga bebja në bebe”. Nëpërmjet këtij premtimi duket se synohet të tregohet qasja dhe boshti social i forcës politike, se sa adresohet ndaj një elektorati specifik dhe që lidhet me premtimet e tjera të deklaruara gjatë fushatës.

Ndër premtimet politike, dallohet premtimi për mosnjohje të ligjeve që janë miratuar nga Kuvendi pas bojkotimit përfundimtar të Kuvendit prej PD dhe LSI. Por, ky premtim është një qasje më shumë e kësaj force politike, sesa një realitet i mundshëm për të ndodhur duke mbajtur në konsideratë përgjegjshmërinë financiare në rast realizimit dhe abrogimi të më shumë se 600 ligje, akte normative me fuqi veprimi si ligji, si dhe akte nënligjore të lidhura me to.


PJESA 3 - Besueshmëria dhe analiza e premtimeve elektorale

Strategjia e komunikimit të secilës parti është e bazuar te prezantimi njëzëri të një programi apo plan veprimi të centralizuar dhe që përsëritet në vijimësi, si nga lideri partiak, por edhe nga zyrtarët e lartë dhe kandidatët për deputetë. Ata njëzëri deklarojnë se partitë e tyre kane hartuar programe dhe plan veprimi te detajuar duke bazuar te kontributet e ekspertëve. Por në pak raste, ata e detajojnë premtimin në program dhe plan veprimi të zbatueshëm bashke me referencat buxhetore dhe mënyrën e akomodimit të premtimit.

3.1. Besueshmëria e premtimeve zgjedhore 2021 dhe 2017

Në zgjedhjet e vitit 2017, premtimet e partive politike janë mesatarisht të besueshme¹⁵ në nivelin prej 36 përqind. Premtimet pak të besueshme¹⁶ janë mesatarisht në nivelin prej 54 përqind. Premtimet e jo të matshme¹⁷ janë mesatarisht në nivelin 10 përqind. Një nivel shumë i lartë besueshmërie, por pak më i cunguar do të rezultonte nëse do të përfshinim edhe premtimet pak të besueshme, duke arritur nivelin prej 90 përqind.

Matja e besueshmërisë së premtimeve zgjedhore,
2017



Nivelin më të lartë të besueshmërisë së premtimeve në 2017 e mban PS dhe në vend të dytë është PD. Vendin e tretë në këtë krahasim e mban LSI. Përsa i përket premtimeve pak të besueshme, shihet se nivelin më të lartë e mban LSI, pas saj vjen PS dhe në vend të tretë është PD. Premtimet jo të matshme gjenden më shumë te PD dhe LSI dhe në vend të fundit është PS.


¹⁵ kur kanë referencë e plotë në të paktën një apo më shumë dokumente strategjike, politike kombëtare

¹⁶ nëse nuk ka referencën e plotë, apo dhe të dhëna të plota për ta matur zbatueshmërinë

¹⁷ kur informacioni aktual nuk është i mjaftueshëm për të gjykuar premtimin, edhe pse premtimi është specifik dhe mund të përcaktohet si një premtim. P.sh. në premtime te caktuara, statistikave përkatëse nuk janë në dispozicion, dhe në raste të tjera informacionet dhe statistikave nuk kane kuptim të përbashkët se cilat duhet të përdoren midis burimeve

Në zgjedhjet e vitit 2021, premtimet e partive politike janë mesatarisht të besueshme në nivelin prej 25 përqind me një rënie të nivelit me 11% më poshtë se zgjedhjet e vitit 2017. Premtimet pak të besueshme janë mesatarisht në nivelin prej 47 përqind dhe janë 7% më poshtë se zgjedhjet e vitit 2017. Premtimet e jo të matshme janë mesatarisht në nivelin 28 përqind, por me një rritje të tyre prej 18 përqind. Një ndryshim kaq disproporcional i nivelit të besueshmërisë është tregues i mosreferimit të partive ndaj qasjeve vizionare dhe strategjike të vendit dhe deklarimeve me bazë populiste dhe për optimalizim të preferencave votuese. Ky tregues vjen me përkeqësim në këto zgjedhje krahasuar me zgjedhjet e kaluara.

Matja e besueshmërisë së premtimeve zgjedhore, 2021



Luhatjen më të madhe të treguesit të besueshmërisë së premtimeve e mban PS me një rënie mbi 1 herë, por në një nivel të madh luhatshmërie PS është edhe për premtimet pak të besueshme me një rritje prej 7%. Premtimet jo të matshme gjenden më shumë të LSI dhe PD, ndërsa në vend të fundit është PS.

Një ndryshim në këto nivele të besueshmërisë së premtimeve është pasojë e orientimit të fushatës së PS drejt premtimeve me bazë jo të gjerë në referencat e politikave strategjike dhe dokumenteve kryesore. Duke anashkaluar këto dokumente për të premtuar oferta elektorale që tregojnë nivelin e rrishtuar të besueshmërisë që vjen për arsye të llogaridhënies dhe ballafaqimit me përmbushjen e objektivave të programit qeverisës.

Nga ana tjetër, niveli më i ulët i besueshmërisë së secilës parti politike është një tregues që shpreh faktin se premtimet e partive orientohen drejt sondazheve dhe preferencave që ato kryejnë me elektoratin shqiptar. Ky nivel premtimesh shpreh faktin e shmangies dhe heqjes dorë nga vizioni i vendit i shprehur në politikat kombëtare dhe orientimi i premtimeve drejt përmbushjes së atyre kërkesave që nga njëra anë tentojnë të realizojnë premtimet e zgjedhjeve të kaluara, të pa përmbushura ende, ndërsa nga ana tjetër kërkojnë të mos mbeten prapa nga oferta elektorale e kundërshtarit.

3.2. Analiza e premtimeve dhe qasja e partive ndaj tyre

Liderët politikë kanë bërë premtime të mëdha përsa lidhet me rritjen e buxhetit për sektorë dhe nënsektorë të ekonomisë dhe grupeve shoqërore më të ndjeshëm ndaj mbështetjes buxhetore. Në dekadën e fundit, përkrah premtimeve për rritje buxheti janë shtuar edhe premtimet për lehtësi dhe përjashtime tatimore. Të gjitha këto zënë të paktën 1/3 e gjithë premtimeve që zotohet t'i realizojë secila parti në zgjedhjet politike.

Mirëpo, kur shohim se kjo vijimësi është një politikë statike, e cila nuk reagon aspak ose shumë pak ndaj sfidave vizionare, atëherë një votues, i cili nuk është votuesi i bindur partiak dhe që ka një nivel integriteti të caktuar social dhe ekonomik shndërrohet zgjedhje pas zgjedhje në tipin e votuesit cinik dhe që nuk është shumë i ndikuar nga çfarëdo premtimi që bëjnë partitë. Natyrisht, që kjo është në dëm të një demokracie të shëndetshme dhe nuk ndihmon në përmirësimin e modelit politik që duhet të përshtaten edhe partitë politike.

VLERËSIMI I PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË TRE PARTIVE KRYESORE NË ZGJEDHJET 2021 *numër*

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2021	PD			PS			LSI		
		Të Besueshme	Pak të besueshme	Jo të matshme	Të Besueshme	Pak të besueshme	Jo të matshme	Të Besueshme	Pak të besueshme	Jo të matshme
1	Arsimi	3	10	6	4	12	2	3	7	5
2	Gruaja dhe Rinia		1			1		1	2	
3	Shëndetësia	2	3	2	3	4	3	1	1	1
4	Ekonomia	2	3	2	1	6	4	2	6	4
5	Mjedisi dhe Turizmi	2	5	2	1	3	3		1	1
6	Bujqësia	2	4	6	2	3	1	2	3	3
7	Politika e Jashtme	4		2			1			
8	Energjia	4	10	5	3	3	3	2		
9	Infrastruktura dhe Transporti		2		7	13	5	1		
10	Fiskale dhe buxheti	2	9	2	3	6	1	1	3	3
11	Politikë	3	3	1		2		1		1
12	Politika sociale	3	8		1	2		1		2
13	Të tjera (administrata, dixhitalizimi, arti etj.)	4	4	9	2	2	1		1	1
PREMTIME GJITHSEJ		31	62	37	27	57	24	15	24	21

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës


Në analizën e premtimeve, një qasje e dedikuar e partive drejt dëshirave të elektoratit dhe jo drejt vizionit të vendit është treguesi më shqetësues, që duhet të alarmojë *së pari* vetë votuesit dhe *së dyti* partitë politike, që kanë rënë në grackën e plotësimit të dëshirave të grupeve të caktuara të votuesve që kënaqen me premtime të lehta (ulja e taksave) dhe përmbushje të tyre në dëm të fuqizimit të financave publike.

Nëse shikojmë në Tabelën më lart, numrin më të lartë të përmbushjes sipas sektorëve dhe grupeve shoqërore bie në sy se asnjë parti nuk ka më shumë se 4 premtime të besueshme për sektor në rastin më të mirë. Ndërkohë shumica e premtimeve të besueshme sipas sektorëve është vetëm me nga 1 premtim të besueshëm. Përveç, premtimeve të besueshme të PS për infrastrukturën rrugore, të cilat janë të besueshme pasi janë planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, asnjë sektor tjetër nuk është në nivele të larta të numrave të besueshëm.

Grafiku më poshtë paraqet peshën e premtimeve të besueshme në raport me premtimet gjithsej që ka deklaruar secila parti politike, për secilin sektor, nga ku shihet se:

- për sektorin e arsimit, gruas dhe rinisë, pesha e premtimeve të besueshme është te LSI me 20%, te PS me 15% dhe te PD me 10%;
- për sektorin e shëndetësisë, pesha e premtimeve të besueshme është te PS me 11%, te LSI me 7% dhe te PD me 6%;
- për ekonominë e vendit, pesha e premtimeve të besueshme është te LSI me 13%, te PD me 6% dhe te PS me 4%;
- për sektorin e mjedisit dhe turizmit, pesha e premtimeve të besueshme është te PD me 6%, si dhe te PS me 4%. LSI nuk rezulton me premtime të besueshme;
- për sektorin e bujqësisë, pesha e premtimeve të besueshme është te LSI me 13%, te PS me 7% dhe te PD me 6%;
- për sektorin e energjisë, pesha e premtimeve të besueshme është te PD dhe LSI me 13%, si dhe te PS me 1%;
- për sektorin e infrastrukturës dhe transportit, pesha e premtimeve të besueshme është te PS me 26%, si dhe te LSI me 7%. PD nuk rezulton me premtime të besueshme;
- për politikat lehtësuese fiskale dhe rritjet e buxhetit, pesha e premtimeve të besueshme është te PS me 11%, te LSI me 7% dhe te PD me 6%;
- për politikat sociale, pesha e premtimeve të besueshme është te PD me 10%, te LSI me 7%, si dhe te PS me 4%.

Niveli besueshmërisë së premtimeve sipas sektorëve, 2021




Ndërkohë, për premtimet politike, për premtimet për administrimin e shtetit, luftën ndaj korrupsionit, si dhe premtime të tjera që përfshijnë integrimin dhe politikën e jashtme shihet se PD ka një nivel më të lartë të peshës së premtimeve të besueshme, ndërsa LSI ka më të ulët. PS mban një nivel të mesëm.

Nga një projeksion krahasues midis premtimeve më të mëdha të bëra nga secila parti dhe në ballafaqim me nivelin e besueshmërisë, vërehet se:

Sipas Grafikut më poshtë, PD ka një sinkronizim të peshës së numrit të premtimeve sipas sektorëve me peshën e besueshmërisë. Ndryshimi i vetëm është në premtimet buxhetore dhe lehtësirat fiskale, ku pesha

e premtimeve është 45% më e madhe se besueshmëria e tyre. Ndërkohë, grafiku tregon një ndërprerje për infrastrukturën, ku nuk ka premtime të besueshme për këtë parti.


PD - Premtimet dhe besueshmëria në 2021



Nga krahasimi midis dy linjave në grafik duket se premtimet më optimale për të funksionuar dhe për të qenë të besueshme edhe për votuesit duke u konsideruar premtime të forta mund të jenë premtimet për energjinë, për arsimin dhe për ekonominë, ku përfshijmë edhe turizmin.

Sipas Grafikut tjetër më poshtë, PS ka një ndryshim të peshës së numrit të premtimeve sipas sektorëve me peshën e besueshmërisë. Ndryshimet e mëdha janë te shëndetësia, bujqësia, infrastruktura, si dhe në premtimet buxhetore dhe lehtësirat fiskale. Në dallim nga grafiku më lart, në rastin e PS niveli i besueshmërisë është më i lartë për peshë më të ulët të premtimeve dhe e kundërta. Dallim në këtë tendencë raportesh bëjnë vetëm premtimet fiskale. Kjo mospërputhje tregon për një mungesë në referencat dhe orientimet sipas qasjeve strategjike, por të orientuar drejt mbushjes së boshllëqeve të programeve të perealizuara të qeverisjes. Shmangiet mes treguesve janë me 2.2 deri 3.8 herë.


PS - Premtimet dhe besueshmëria në 2021



Nga krahasimi midis dy linjave në grafikun me lart duket se premtimet më optimale për të funksionuar dhe për të qenë të besueshme edhe për votuesit duke u konsideruar premtime të forta mund të jenë premtimet për arsimin, gruan e rininë, për ekonominë, ku përfshijmë edhe turizmin, politikat sociale, si dhe për energjinë.

Sipas Grafikut më poshtë, ku paraqitet krahasimi i peshës së numrit të premtimeve sipas sektorëve me peshën e besueshmërisë për LSI, shihet se ka ndryshime të mëdha midis tyre. Ndryshimet e mëdha janë te bujqësia, energjia, ekonomia duke përfshirë edhe turizmin, si dhe te premtimet buxhetore dhe lehtësirat fiskale. Në ngjashmëri me grafikun më lart, edhe për rastin e LSI, niveli i besueshmërisë është më i lartë për peshë më të ulët të premtimeve. Edhe për LSI, dallim në këtë tendencë raportesh bëjnë vetëm premtimet fiskale dhe buxhetore. Treguesit sipas linjave që shihen në grafik rezultojnë më të larguar nga njëri-tjetri (mospërputhje) në rastin e politikave lehtësuese fiskale, energjinë dhe transportin. Edhe kjo parti dukshëm tregon për një mungesë në referencat dhe orientimet sipas qasjeve strategjike. Shmangiet mes treguesve janë me 2.1 deri 4.3 herë.

LSI - Premtimet dhe besueshmëria në 2021



Nga krahasimi midis dy linjave në grafikun më lart duket se premtimet më optimale për të funksionuar dhe për të qenë të besueshme edhe për votuesit duke u konsideruar premtime të forta mund të jenë premtimet për arsimin, gruan e rininë, për shëndetësinë, politikat sociale, si dhe për ekonominë.

3.3. Referimi te vizioni vendit dhe përgjegjshmëria në përcëimin e tij

Vizioni i integritimit të Shqipërisë në BE, është orientimi më madhor i Shqipërisë, që pas periudhës kur vendi hyri në një rend shoqëror me sistem politik të ri, që përkon me përshtatjen e modelit të demokracive liberale. Është një vizion, i cili përmbledh gjithë modelimin e vendit drejt realizimit të objektivave strategjike për secilin sektor të jetës dhe aspiratë madhore të shqiptarëve të këtij shekulli. Në Shqipëri, klasa politike shqiptare ka një konsensus të pashembullt për qasje të tjera politike, në raport edhe me shumë vende të tjera të BE që janë anëtare të BE, për çështjen e integritimit.

Nisur nga vizioni më kryesor i vendit, në këtë studim jemi angazhuar të studiojmë se si mundet që nëpërmjet premtimeve zgjedhore, të cilat prekin kolonat më kryesore për arritjen e objektivave në funksion të vizionit të bëjmë të mundur dhe të prekshme për votuesit, ato qasje që vlejné dhe i shërbejnë publikut në sinkron me nevojat e vendit.

Në analizën midis premtimit për punësimet me qasjen ideologjike të partive nëse ekonomia rritet, si rezultat i kapitalizmit, ne mund të shpresojmë me besim se edhe e ardhmja e punësimit dhe kushteve të jetesë do të jenë më të mira se e tashmja.

Punësimi është i lidhur organikisht me rritjen ekonomike, e cila kërkon ndryshim dhe zgjerim të kapaciteteve për tu bërë faktor ndikues në arritjen e premtimit të punësimit. Por, një rritje punësimi mund të imponojë disa kosto të menjëhershme sociale dhe ndryshime të mënyrës së jetesës. Kjo është e vërteta e madhe e tregut tonë kapitalist dhe kaotik, ku askush nuk e di se ku do të na çojë dinamika e tij. Në vitet '90 ishte konsumi ai që orientoi tregun dhe tashmë kemi një treg të mbështetur te tregtia dhe shërbimet. Ndërkohë, në vitet 2000 krahas tregtisë dhe shërbimeve, filloi të zgjerohej tregu drejt bujqësisë dhe prodhimeve të bazuara te burimet nëntokësore. Një dekadë përpara (2010) tregu filloi të shtohet me industrinë e përpunimit të lëndës së parë duke shfrytëzuar fuqinë e lirë, por të paaftësuar të vendit. Ndërkohë, në dekadën e re që kemi hyrë, politika kërkon të zhvillojë ekonominë duke u përpjekur të rigjallërojë konsumin e brendshëm kryesisht nëpërmjet shërbimeve dhe investimeve në energji dhe infrastrukturë. Por ajo pjesë e tregut që ka rezistuar është sa formale, po aq dhe informale, pra një treg ku kaosi dhe mungesa e rregullit ndikon për ta frenuar edhe pjesën tjetër të tregut kur rregullat dhe ligji kanë krijuar një traditë tjetër.

Por, në rastin e analizës për punësimin bazuar te tregu, në tre zgjedhjet e kaluara është matur se niveli më i lartë i realizuar i punësimit në vend (përfshirë dhe formalizimin e tregut të punës) është arritur në dekadën kur investimet dhe shërbimet filluan të kenë një vlerë të shtuar dhe fuqia e lirë punëtore nuk shihej më nga qeveria si një favor për të rritur punësimin nëpërmjet investimeve.

PREMTIMI - NUMRI I TË PUNËSUARVE TË RINJ PËR 4 VITE, 2021 -2025

NUMRI I TË PUNËSUARVE	numër		
	PD	PS	LSI
	110,000	150,000	105,000

Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

Nisur nga kjo logjikë, si dhe duke parë në këndvështrim të gjerë orientimin e premtimeve në mënyrë konsensuale të tre partive drejt arsimit profesional, teknologjisë dhe inovacionit natyreshëm që edhe premtimet për numrat e punësimit sipas tabelës më lart janë të besueshëm dhe në kushte të mundshme të realizimit të tyre në masë të madhe. Në një ballafaqim me qasjen ideologjike të kraheve politikë, në rastin e premtimit për punësim mund të thuhet se nuk ka kufij politikë midis partive dhe të gjitha premtimet synojnë të jenë të sinkronizuara me premtimet e kundërshtarit politik.

Në premtimet zgjedhore të vitit 2021 është me rëndësi të përmendim faktin, se partitë kanë reaguar për të korrigjuar premtimet e papërgjegjshme në zgjedhjet e kaluara për rritje të punësimeve jashtë çdo realiteti të tregut dhe dimensioneve ekonomike të Shqipërisë.

Partitë politike në këto premtime të reja nuk prezantojnë programe dhe projekte për realizimin e tyre, por nisur nga premtimet në tërësi ne kemi llogaritur ndikime dhe efekte direkte në lidhje me besueshmërinë

që ka të bëjë me logjikën financiare dhe jo me dokumentet strategjike, të cilat kanë nevojën e tyre të përshtaten për çdo vit.

PD ka premtuar për 110 mijë vende pune, të cilat ajo angazhohet ti realizojë përmes rritjes së ekonomisë dhe uljes së normave tatimore dhe përgjithësisht taksave të punës.

Nisur nga llogaritja e kontributit të gjithë sa është premtuar, vlera e shtesës së PBB-së synohet të rritet me 5.6% në vit. Kjo gjeneron një nivel punësimi që teorikisht përkon me numrin e premtuar prej 110 mijë vende pune në 4 vite.

PS ka premtuar për 150 mijë vende pune, të cilat angazhohet ti realizojë përmes rritjes së prodhimit dhe eksportit të produkteve energjetike, bujqësore, projekteve infrastrukturore, konsumit të brendshëm të ekonomisë dhe uljes së normave tatimore, kryesisht për tatimin e kapitalit për biznesin e vogël (Tatimi fitimit të thjeshtuar) dhe për individët e pasur (tatimi i dividendit).

Nga një llogaritje e kontributit të gjithë sa është premtuar duket se synohet që vlera e kontributeve të sektorëve drejt rritjes së PBB-së të arrijë në 6% në vit duke gjeneruar potenciale për një nivel punësimi që teorikisht përkon me angazhimin për 150 mijë vende pune në 4 vite.

LSI nuk ka premtuar vende pune me objektiva të shprehur në numra. Por, një premtim që gjeneron punësim është shprehur nëpërmjet krijimit të zonave të lira, të cilat sipas analizës tonë pas njohjes së përgjithshme me projektet specifike të paraqitura nga ekspertët të LSI nuk kalojnë numrin e 5 mijë të punësuarve. Nga ana tjetër, nëse llogaritim efektet nga premtimet për formalizimin nëpërmjet rimbursimit të konsumit, si dhe angazhimit politik për një rritje të madhe të prodhimit bujqësor për eksport dhe asistimit ndaj industrisë fason, të kombinuara me uljen e normave tatimore mundet të ketë një qasje kontributive të vlerës së shtuar me të paktën 4.5% në PBB.

Kjo normë rritje, e cila është llogaritje teorike e premtimeve të konvertuara në vlerë të rritur për ekonominë mund të gjenerojë potenciale për një nivel punësimi që në tërësinë e tyre arrin të angazhojë 105 mijë vende pune në 4 vite.

Në llogaritjet që janë bërë për të arritur në një vlerësim të mundësive reale të përmbushjes së premtimeve nga një qasje hipotetike si më lart deri sa të verifikohen me përmbushjen reale të tyre, ne kemi analizuar edhe infrastrukturën e tregut financiar dhe mënyrën e përgjegjshmërisë së politikanëve në mosrënien në përsëritje të premtimeve nga njëra zgjedhje në tjetrën duke ndryshuar formën e jashtme, por pa ndryshuar elemente thelbësore përmbajtjes.

Në sqarimin për sa lidhet me tregun financiar dhe mundësitë e tij për të përthithur vlera investimesh në mallra, shërbime dhe vlera monetare nevojitet që të ndërmerret në të njëjtën kohë me realizimin e premtimeve edhe një zgjerim dhe përmirësim i këtij tregu, për arsye të pamundësisë aktuale për të përthithur shuma qindra milionë euro pa patur kapacitetin real për ti transmetuar ato në projekte.

Një ndikim tjetër me peshë vlen për financat publike nga efekti i qarkullimit të tepruar të Euros. Një qarkullim monetar i mbingopur nga oferta e Euros ndikon në stabilitetin fiskal, i cili llogaritet dhe bazohet te Leku. Në rastin kur kemi qarkullim masiv monetar në Euro, pakësimi i qarkullimi të Lekut në transaksione ul prezencën e tij në treg dhe në të njëjtën kohë ndikon në uljen e ritmeve të konsumit duke u përkthyer në më pak taksa për tu mbledhur. Ky moment e bën të domosdoshëm kombinimin e politikës monetare me atë fiskale, pasi nga ana tjetër e gjithë kjo politikë duhet të marrë në konsideratë edhe efektin e ekonomisë informale, që kërkon të formalizohet nëpërmjet politikës së deuroizimit dhe projekteve të mëdha infrastrukturore civile dhe private.

Në rast, se premtimet do të ishin të detajuara në formatin e projekteve të bizneseve, atëherë të gjithë rrisqet që ndesh një premtim deri në realizimin e tij do të ishin më të vlefshme për të fituar besimin e ekonomisë dhe të votuesve, të cilët gjithsesi priren të besojnë sa herë premtohen shuma të mëdha investimesh.

Në këtë analizë të përgjegjshmërisë partiake në përçimin e vizionit duke patur parasysh edhe kufijtë ideologjikë që shoqërojnë bazat e votuesve të partive, sipas tabelës më poshtë vërehet se asnjë nga partitë nuk i ruan kufijtë e sa ideologjikë. Në të gjitha partitë janë të njëjtat qasje në përsëritjen e premtimeve për punësime në numra të mëdhenj, për rritje pagash mbi, rritje buxheti për sektorë të ekonomisë, përjashtime dhe lehtësi fiskale. Këto premtime që përbëjnë 10-15% të premtimeve të politikanëve shqiptarë janë një *modus vivendi* midis parive politike konfliktuale të vendit. Përtej premtimeve të ngjashme, secila nga partitë nuk arrin dot të prezantojë qasje të ndryshme për realizimin e të njëjtave premtime. Ndërsa, premtojnë shtim buxhetesh, ato nuk qartësojnë se si do të arrihet që ky buxhet i shtuar të konvergojë me objektivin e premtimit.

PËRSËRITJE E PREMTIMEVE NË ZGJEDHJET 2021

Nr.	Premtimet	PD	PS	LSI
1	Rritje punësimi	PO	PO	PO
2	Rritje pagash	PO	PO	PO
3	Rritje shpenzimi buxheti sektorial	PO	PO	PO
4	Heqje/zerim tatimi	PO	PO	PO
5	Ulje tatimi	PO	PO	PO
6	Formalizim/ Taksat të reja	JO	JO	PO

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Këto premtime të përsëritura bëhen për një arsye të thjeshtë dhe shumë të leverdishme për maksimalizimin e votës në favor të partisë që premtonte atë që duan të dëgjojnë votuesit, shtimin e investimeve për më shumë punësime, si dhe uljen e taksave për më shumë para në xhepin e konsumatorëve. Dhe në fakt këto premtime funksionojnë edhe pse nuk arrijnë të përmbushen asnjëherë.

Ne konstatojmë pas konsultimeve me grupe të ndryshme qytetarësh, se kategoria e votuesve me besim më të ulët të politika janë ata që janë mbështetës të transfertave nga buxheti në raport me prokurimet e të mirave publike, duke qenë më shumë të interesuar për kategorinë e shpenzimeve buxhetore afatshkurtra dhe që justifikojnë humbjen e durimit me premtimet e politikanëve.

Por, ndryshimi i kësaj tendence ndodh më ngadalë se koha zgjedhore.

Studime të ndryshme dhe analiza të bëra për Shqipërinë vlerësojnë se qytetarët me besim të ulët janë të prirur të ndryshojnë zgjedhjet e tyre nga politika inefficente, nëse ata binden me fakte apo prezantime të qarta për politika relativisht më eficientë.

Premtimet e politikanëve në 12 vitet e fundit (2009-2021) e ndryshojnë qasjen e tyre pikërisht se ata vetë njihen me analizat e ekspertëve brenda partive, që lidhin rezultatin zgjedhor me premtimet dhe realitetin e përmbushjes së tyre. Por, në garën e premtimeve midis partive nuk vlejnë shumë llogaritjet, por deklarimi i premtimeve jorealiste, që ndryshon edhe nga qenia në pozitë apo opozitë të tyre. Kështu, në një vazhdim

të argumentimit lidhur me faktin e përgjegjshmërisë në funksion të vizionit, ne analizuam nivelin e premtimeve sektoriale të partive kur ato janë në opozitë dhe nivelin e premtimeve kur ato janë në pozitë dhe kërkojnë vijimësinë nga votuesit.

Në rastin e premtimeve nga pozitë e një opozitari, secila nga partitë shihet se premtonte me shumicë për ulje dhe heqje tatimesh e taksash, për investime dhe shtim të buxhetit për sektorët ku punojnë e jetojnë një pjesë e madhe e votuesve, si dhe për arsimin, gruan dhe rininë për ti shërbyer maksimalizimit të votës, pa hyrë në analiza për një masë të pranueshme dhe të realizueshme.

Tendenca e premtimeve të partive në opozitë, 2009-2021

Nr	Tipi i premtimeve	PD		PS		LSI		
		2017	2021	2009	2013	2009	2017	2021
1	Fiskale dhe buxhetore	29%	29%	14%	11%	6%	34%	31%
2	Sociale	8%	4%	11%	11%	15%	5%	3%
3	Shëndetësore	2%	5%	11%	5%	10%	5%	3%
4	Edukimi dhe gruaja	13%	10%	11%	8%	21%	5%	20%
5	Infrastruktura dhe energjia	4%	15%	5%	21%	8%	7%	5%
6	Bujqësia dhe Turizmi	17%	11%	23%	21%	14%	37%	10%
7	Ekonomia	0%	7%	2%	1%	5%	7%	19%
8	Politike dhe të përgjithshme	27%	19%	23%	22%	21%	0%	8%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Ndërsa, kur partitë politike premtojnë në pozitë e një qeveritari, që kërkon të rrijë ende në zyrat e shtetit për të vijuar përmbushjen e premtimeve, vërehet se partitë kanë ndryshime në orientimin sektorial të premtimeve. Përgjithësisht premtimet e tyre orientohen në ato projekte që janë ende në proces dhe të buxhetuara. Por, ndërkohë harta e shpërndarjes së premtimeve nuk ka polarizimin dhe shpërndarjen e tyre sektoriale, që vërehet kur janë në opozitë.

Tendenca e premtimeve të partive në pozitë, 2009-2021

Nr	Tipi i premtimeve	PD		PS		LSI	
		2009	2013	2017	2021	2013	2017
1	Fiskale dhe buxhetore	8%	11%	27%	30%	12%	34%
2	Sociale	4%	4%	12%	2%	10%	5%
3	Shëndetësore	4%	0%	8%	4%	10%	5%
4	Edukimi dhe gruaja	18%	4%	25%	14%	12%	5%
5	Infrastruktura dhe energjia	31%	32%	5%	22%	26%	7%
6	Bujqësia dhe Turizmi	18%	20%	14%	6%	16%	37%
7	Ekonomia	3%	7%	2%	8%	6%	7%
8	Politike dhe të përgjithshme	14%	21%	7%	15%	8%	0%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Në premtimet që bëhen për mandate të dyta qeverisje, shpërndarja e premtimeve orientohet nga performancat sektoriale, të cilat marrin edhe vëmendjen e partisë në qeverisje. Por, ndërkohë, një tendencë e dytë për partitë në pozitë është edhe nevoja që të ribëjnë premtimet që nuk i kanë realizuar apo i kanë në procese fillestare.

Në një analizë të tërësisë së hartimit të premtimeve sipas vizionit të vendit, si dhe nisur nga nevojat për të qenë konkurruesë në tregun rajonal shikohet se ka një tendencë të bërjes së premtimeve që i shërbejnë pak vizionit të vendit, pasi nxitja më e madhe e premtimeve është të stimulojnë kërkesën e votuesve nëpërmjet premtimeve të lehta për tu realizuar (premtimet fiskale) dhe të arritshme brenda mandatit qeverisës.

3.4. Kostoja buxhetore dhe fiskale e premtimeve të partive

Përvoja e vendeve të zhvilluara tregon se analizat e kostove buxhetore dhe fiskale të premtimeve bëhen me ekspertë, të cilët nuk janë anonimë për publikun. Angazhimet zgjedhore në shumë vende paraqiten bashkë me kostot e tyre reale gjatë katër viteve të qeverisë, ndërsa dy palët munden më tej të kontestojnë shifrat e njëra-tjetrës.

Për rastin e partisë/ve në qeverisje, angazhimet e buxhetit analizohen në avancë nga zyrtarët e financave të qeverisë. Ndërsa angazhimet buxhetore të opozitës dërgohen në kompani të njohura kontabiliteti dhe fiskale, të cilat i japin edhe besueshmërinë llogaritjeve matematikore të premtimeve zgjedhore.

Lista e premtimeve që kalojnë për llogaritje të kostove të tyre nuk përfshin projekte tashmë të financuara ose në proces. Partitë renditin shpenzimet e kryera vetëm nga Buxheti i Shtetit dhe jo nga nivele të ndryshme financimesh nga sektori privat apo partnership me të. Kryesisht renditen premtimet zgjedhore, ku kostoja e vlerësuar e buxhetit është e publikuar në faqen zyrtare të partisë.

Ky është procesi që ndodh në shumë vende në rastin e premtimeve.

Ndërsa, kur analizojmë mënyrën se si veprohet në Shqipëri për llogaritjen e kostove buxhetore në praktikën e komunikimit të programeve elektorale ndodh në raste të shpëputura dhe jo të organizuar të jenë përgatitur për votuesit dhe publikun analiza mbi kostot e premtimeve dhe efektet e tyre.

Partitë politike shqiptare në prezantimin e premtimeve që kanë lidhje direkte me kosto buxhetore shprehen se janë të konsultuara me ekspertët e tyre, por që në fakt në gjithë fushatat e kaluara, por edhe në këtë fushatë, pas monitorimit të bërë nga ana jonë, premtimet dhe programet nuk paraqiten dhe mbrohen në pothuaj asnjë rast nga ekspertë/teknikë të partive sipas formatit të prezantuar nga përvoja si më lart.

Nga ana tjetër, vetë ekspertët edhe nëse kanë punuar mbi kostot e programeve nuk janë aq naivë sa të besojnë se mund të veprojnë në një zonë ku është e lirë nga politika dhe preferojnë të jenë anonimë.

Krahët politikë kanë vazhduar të japin mesazhe për votuesit edhe në këto zgjedhje që janë në kundërshtim me llogaritjet dhe sqarimet nga ekspertët e administratës publike dhe të sektorit privat. Rezultati i gjithë procesit është një ambient politik e social, që në mënyrë kronike dërgon mesazhe të përziera dhe kundërshtuese me njëra-tjetrën, duke shtuar mospërrputhjen e përgjigjes për premtimet me kosto buxhetore si për shpenzimet, po ashtu edhe për të ardhurat.


Në mungesë të kësaj tradite, që nevojitet të marrë kohën e vet edhe për ambientin politik shqiptar, stafi jonë i ekspertëve kanë bërë llogaritjet dhe analizën e munguar në programet zgjedhore, apo edhe plan veprimin e qeverisë.

Sa kushtojnë projektet buxhetore sipas sektorëve?

Në llogaritjen e kostove të premtimeve që varen nga buxheti i shtetit është analizuar dhe konsultuar për çdo rast se sa është parashikuar së pari në buxhetin e vitit të parë të Programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023, si dhe në vijimësi është bërë edhe llogaritja mesatare në rastet kur premtimi buxhetor zgjat nga 2-4 vite apo edhe më tej. Në çdo rast kur PBA 2021 -2023 nuk parashikon kosto specifike për llogaritjet, ne kemi përdorur dokumente të tjera shtesë që kanë përshkrim në dokumente strategjike, në P.K.I.E, në publikimet e INSTAT, në publikime të tjera të politikave sektoriale, ligje apo në gjithë referencat që janë përdorur për të matur besueshmërinë e secilit premtim të partive kryesore në vend.

Në rastin e të hyrave buxhetore janë llogaritur gjithë efektet duke patur parasysh se për çdo investim ka një lidhje të ngushtë edhe efekti që i vjen ekonomisë dhe më tej të ardhurave buxhetore, si nëpërmjet kapitalizimit të tyre, po ashtu edhe për rritjen e konsumit dhe të fuqisë punëtore. Këto efekte së bashku janë llogaritur si efekte plus në të ardhurat e buxhetit dhe si efekte minus për premtimet e lehtësive tatimore për investime të caktuara, që në këto raste janë të ardhura që i hiqen buxhetit të vitit.

KOSTOT FISKALE E BUXHETORE TE PREMTIMEVE ELEKTORALE, 2021



Në grafikun më lart janë paraqitur shumat finale, që rezultojnë nga llogaritjet për çdo sektor, për të cilin premtimi i dhënë është direkt ndikues në shpenzimet apo të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Në premtimet elektorale 2021 shihet se PD ka vlerën më të lartë të efekteve në shpenzimet buxhetore në krahasim me PS dhe LSI. Premtimet për shpenzimet për sektorë dhe shtresa të ndryshme sociale arrijnë në një vlerë absolute vjetore prej - 140.7 miliard lekë. Ndërsa efekti i premtimeve në të ardhurat arrin në 28.2 miliard lekë, që llogaritet se do të gjenerohen nga premtimet për rritjen ekonomike, për rritjen e punësimit, si dhe për investime në sektorë ku ekonomia e rimerr investimin. Por, nëse efektet nga premtimet për lehtësi fiskale (- 50.7 miliardë lekë në vit) do ti heqim nga shpenzimet buxhetore (-140.7 mld. Lekë) dhe do ti llogaritim në krahun e të ardhurave, atëherë shuma që del si rrjedhojë jep një shumë negative me – 22.5 miliard lekë (në vend të 28.2 mld. Lekë si është në grafikun e PD). Rezultati buxhetor (deficiti) është – 112.5 miliard lekë.

PS arrin që të ketë një efekt negativ prej - 100.4 miliard lekë në vit në shpenzimet buxhetore, në rast se do të zbatohen premtimet elektorale 2021. Ndërsa të ardhurat që mund të gjenerohen nga zbatimi politikave të zhvillimit ekonomik, investimeve dhe punësimit llogariten të jenë në + 9.2 miliard lekë në vit. Por duke zbritur efektin negativ me - 6.5 miliard lekë në të ardhurat nga premtimet e lehtësive fiskale, shuma që del si rrjedhojë mbetet në efekt neto prej 2.7 miliard lekë (shih grafikun e PS). Rezultati buxhetor (deficiti) është – 97.7 miliard lekë.

Premtimet elektorale të LSI prodhojnë një efekt negativ në shpenzimet buxhetore me - 33.3 miliard lekë. Nëse nga ky efekt zbrësim ndikimin që prodhojnë premtimet për ekonominë dhe investimet me 3.9 miliardë lekë të hyra buxhetore vjetore, atëherë deficiti buxhetor që shkaktojnë premtimet në rast zbatimi të tyre është 29.3 miliardë lekë.

Në llogaritjet që kemi arritur të kryejmë duke analizuar lidhjen midis rritjes ekonomike me rritjen e barrës fiskale ndaj PBB-së në periudhën 2010 -2018, rezulton se:

- nga krahasimi midis rritjes ekonomike për periudhën 2014-2018¹⁸, si dhe barrës fiskale ndaj PBB-së për të njëjtën periudhë, për çdo 1% rritje ekonomike korespondon një rritje e të ardhurave fiskale me 1% e PBB-së;
- nga krahasimi midis rritjes ekonomike për periudhën 2010-2014¹⁹, si dhe barrës fiskale ndaj PBB-së për të njëjtën periudhë, për çdo 1% rritje ekonomike korespondon një rritje e të ardhurave fiskale me 0.68% e PBB-së.

Ky tregues që llogaritet bazuar mbi studimin e të dhënave fiskale dhe makroekonomike shqiptare, mund të themi se mesatarisht, për çdo 1% rritje të prodhimit të brendshëm llogaritet e rritjes mesatare të të hyrave fiskale janë sa 0.8% e PBB-së.

Nga grafiku më poshtë, ku paraqiten kostot financiare të premtimeve të PD, sipas sektorëve vërehet se:

- premtimet për ekonominë, për turizmin dhe mjedisin, për energjinë, për shëndetësinë, për arsimin, për bujqësinë, për infrastrukturën, për kulturën, për lehtësirat fiskale janë me rezultat pozitiv në buxhet 28.2 miliard lekë në vit, në rast të zbatimit të premtimeve në programe qeverisëse;
- premtimet për arsimin, gruan, rininë, për shëndetësinë, për bujqësinë, për lehtësimet fiskale, për politikat sociale, për kulturën, si dhe premtimet politike dhe ato për administrimin ndikojnë me një vlerë shpenzimesh prej 125.4 miliard lekë, në rast se do të marrim në konsideratë zbatimin e premtimeve për alokimet buxhetore sipas sektorëve;

Në gjithë analizën e kostos së premtimeve bie në sy efekti nga premtimet për lehtësimet fiskale²⁰, të cilat ndikojnë mbi efektet pozitive në të hyrat fiskale si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe investimeve duke zhbërë efektin pozitiv të tyre në buxhet, i llogaritur me 18.5 miliard lekë me një rezultat negativ rezultant – 22. 5 miliard lekë në të hyrat fiskale²¹.

¹⁸ <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2020/English/1ALBEA2020002.ashx>

<https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2019/cr1929-Albania-A4.ashx>


¹⁹ <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2020/English/1ALBEA2020002.ashx>

<https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2019/cr1929-Albania-A4.ashx>

²⁰ me një efekt – 51 miliard lekë/vit në të ardhurat e munguara prej dhe + 9.7 miliard lekë në të hyrat fiskale

²¹ të hyra fiskale shtesë nga rritja ekonomike minus të hyra fiskale nga premtimet për heqje dhe ulje taksash e kontributesh

KOSTOJA E PREMTIMEVE ELEKTORALE, PD 2021 (mld. Lekë)



Sektorët që pritet të kenë më shumë shpenzime buxhetore shtesë sipas premtimeve janë:


- politikat sociale me 34 miliard lekë në vit, arsimi me 18.6 miliard lekë në vit, bujqësia me 17.2 miliard lekë në vit, infrastruktura me 6.5 miliardë lekë në vit, shëndetësia me 4.9 miliardë lekë në vit. Sektorët dhe programet e tjera paraqesin një vlerë shpenzime deri 1 miliard lekë në vit.

Nga grafiku tjetër më poshtë, në të cilin paraqiten kostot financiare të premtimeve të PS, sipas sektorëve vërehet se:

- premtimet për ekonominë, për turizmin dhe mjedisin, për energjinë, për arsimin, për bujqësinë, për infrastrukturën, për kulturën janë me rezultat pozitiv në buxhet 9.2 miliard lekë në vit, në bazë të zbatimit të projekteve sipas premtimeve;

- premtimet për infrastrukturën dhe transportin, për arsimin, gruan, rininë, për shëndetësinë, për bujqësinë, për lehtësimet fiskale, për politikat sociale, për kulturën, për dixhitalizimin, si dhe premtimet për administrimin ndikojnë me një vlerë shpenzimesh prej 100.4 miliard lekë, në rast se do të jenë pjesë e programit qeverisës duke llogaritur alokimet buxhetore respektive shtesë sipas sektorëve;

KOSTOJA E PREMTIMEVE ELEKTORALE, PS 2021 (mld. Lekë)



Në analizën e koston së premtimeve duket se efekti nga premtimet për lehtësimet fiskale²², të cilat ndikojnë mbi efektet pozitive në të hyrat fiskale si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe investimeve duke zhbërë efektin pozitiv të tyre në buxhet, në një rezultat të ulët rezultant me 2.7 miliard lekë në të hyrat fiskale.

Sektorët që pritet të kenë më shumë shpenzime buxhetore shtesë sipas premtimeve janë:

- infrastruktura me 48.2 miliardë lekë në vit, politikat sociale me 18 miliard lekë në vit, arsimi me 12.8 miliard lekë në vit, shëndetësia me 8.9 miliardë lekë në vit, dixhitalizimi dhe energjia me nga 2.5 miliard lekë në vit , kultura me 1.8 miliardë lekë në vit. Sektorët dhe programet e tjera paraqesin një vlerë shpenzime deri 1 miliard lekë në vit.


Nga grafiku më poshtë, që paraqet kostot financiare të premtimeve sipas sektorëve të bëra nga LSI, vërehet se:

- premtimet për arsimin, për ekonominë, për lehtësirat fiskale janë me rezultat pozitiv në buxhet 4 miliard lekë në vit, në rastin kur premtimet do të merren të përfshihen për zbatim nga PD, si pjesë e koalicionit qeverisës;

- premtimet për arsimin, gruan, rininë, për bujqësinë, për lehtësimet fiskale, për politikat sociale ndikojnë me një vlerë shpenzimesh prej 33.3 miliard lekë, në rast se do të jenë pjesë e programit qeverisës duke llogaritur alokimet buxhetore respektive shtesë sipas sektorëve;

²² me një efekt – 1.7 miliard lekë/vit në të ardhurat e munguara prej dhe -6.5 miliard lekë në të hyrat fiskale

KOSTOJA E PREMTIMEVE ELEKTORALE, LSI 2021 (mld. Lekë)



Në analizën e kostonë së premtimeve duket se efekti nga premtimet për lehtësimet fiskale²³, të cilat ndikojnë mbi efektet pozitive në të hyrat fiskale si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe investimeve duke zhbërë efektin pozitiv të tyre në buxhet, në një rezultat negativ rezultant me -4.3 miliard lekë në të hyrat fiskale.

Sektorët që pritet të kenë më shumë shpenzime buxhetore shtesë sipas premtimeve janë:

- arsimi me 10.5 miliard lekë në vit, bujqësia me 9 miliardë lekë në vit, politikat sociale me 2.6 miliard lekë në vit. Sektorët dhe programet e tjera paraqesin një vlerë shpenzime deri 1 miliard lekë në vit.

Vlen të veçojmë si rast premtimet e partive politike për **rritjen e pensioneve**.

Duke marrë në konsideratë, se afër ¼ e popullsisë janë në moshë pensioni dhe mbështeten vetëm në pensionin kontribues të shtetit për të ardhurat e tyre ky grup votuesish janë edhe votuesi më i lidhur me premtimet e politikës.

Në zgjedhjet e vitit 2021, partitë e majta nuk kanë bërë premtime për pensionet, ndërkohë që PD ka bërë premtim për rritje të tyre, një premtim që përsëritet në çdo zgjedhje.

Për shkak se pensionistët që hyjnë rishtazi janë duke e rritur me shpejtësi, barrën e buxhetit për pensionet nuk arrijnë dot ta mbajnë premtimet për rritje të tyre, pasi së pari mbështetja buxhetore për to duhet të vijë nga rritja e performancës së mbledhjes së kontributeve, formalizimit të tregut të punës, si dhe zbatimi i një skeme gjithpërfshirëse të skemës publike me skemën private të pensioneve.

²³ me një efekt – 8.2 miliard lekë/vit në të ardhurat e munguara prej dhe 1.2 miliard lekë në të hyrat fiskale

PJESA 4 - Trendi i ofertave elektorale 2009-2021

Politika në gjithë këto vite demokracie ka ndikuar plotësisht procesin e analizave teknike, bazuar mbi hulumtimet dhe paraqitjet e fakteve të kryera si nga gazetaria investigative, por dhe nga analiza politiko-ekonomike të specialistëve të ndryshëm. Rezultati i gjithë kësaj qasje të politikës ka ndikuar në përhapjen e një epidemie mosbesimi te qytetarët. Kjo ka minuar më tej përgjigjen tashmë kaotike dhe joefektive të votuesve ndaj mungesës së përgjegjshmërisë politike dhe ekonomike të politikanëve që kanë qeverisur sipas rotacioneve politike.

Ambienti i ngarkuar politikisht nuk ka lejuar që të debatohet mbi koston e zotimeve elektorale për të sqaruar votuesit nëpërmjet debateve të nevojshme teknike. Kjo qasje negative i ka munguar procesit të marrëdhënieve mes politikës dhe qytetarëve në kontekstin e sqarimit të kontratës sociale, e cila hartohet nga politikanët dhe u jepet për ta votuar dhe aprovuar votuesve çdo 4 vite. Sa më gjatë që testohen programet dhe premtimet sipas sektorëve të ndryshëm përpara se të lëshohen për zbatim, aq më shumë ka gjasa që ato të jenë të sigurta dhe efektive. Mirëpo, ky proces nuk ka ndodhur në të kaluarën dhe duket se as në këtë proces zgjedhor nuk ka gjasa të ketë hapësirën e nevojshme. Megjithëse, qasje të ngjashme si ky studim po bëhen dhe po përhapen si frymë e re edhe nga organizata të tjera të shoqërisë civile duket se politika nuk lëshon hapësirën pa një ballafaqim fakt mbas fakti dhe duke ju adresuar votuesve dhe jo atyre gjithë argumentet e mundshme për të treguar përgjegjshmërinë reale të premtimeve të politikës.

4.1. Ofertat elektorale dhe krahasimi mes partive

Në hulumtimin e fakteve për të analizuar tendencën e ofertës elektorale të bazuar në premtimet e vitit 2021 ne kemi kryer kërkime me një fokus në pjesën më të madhe të përgjigjes ndaj pyetjes se:

- Pse nuk i tregojnë partitë politike kostot e premtimeve që prezantojnë për qytetarët, por edhe stafet e teknikëve që hartojnë programet për të patur një debat sa më të gjerë teknik bazuar mbi fakte dhe gjetje?

Në realitet premtimet paraqiten si paketa shpëtimi nga situatat që mbajnë përgjegjës mungesën e një politike jo konsensuale dhe të përgjegjshme. Por, në fakt politika nuk ka paraqitur tashmë prej më shumë se 10 vitesh oferta elektorale që prezantojnë vizion të bazuar te qasje politikash strategjike, si dhe nuk dalin dot nga politikat afatshkurtra dhe me synim përfitime personale dhe të grupimit politik.


Ofertat politike ngjajnë me paketat për mbijetesë. Në fakt, qytetarët presin propozime që diktojnë procese zhvillimi njësoj si po ecin disa vende të rajonit që po e lënë mbrapa Shqipërinë. Premtimet e sotme duhet të ishin realizimet e djeshme. Të tilla gjen me shumicë në koshin e programeve zgjedhore të partive duke filluar nga premtimi i zgjidhjeve të çështjeve të pronësisë, dhe formalizimit të ndërtimeve dhe duke vijuar me premtimet për cilësinë e produkteve, të jetës dhe uljen e kostos së jetesës duke garantuar ujin e munguar dhe energjinë e gjelbër, që ende nuk ka adresuar problemet financiare, por edhe ato të mirëadministrimit.

Por, a ju janë kthyer kundër politikisht gjithë këto mospërmbushje premtimesh?

- Përgjithësisht, jo!

Gjetjet tona sugjerojnë që premtimet për transferime të fondeve të buxhetit dhe lehtësirave fiskale mund të jenë të rëndësishme për rezultatet e zgjedhjeve, por jo vendimtare, pasi nuk ka një korrelacion të fortë që për premtime të mëdha për transferata fondesh buxhetore të ketë një rritje të rezultatit zgjedhor. Sipas Grafikut më poshtë ka një lidhje midis shtimit të premtimeve buxhetore me një rezultat zgjedhor më të mirë për secilën nga partitë e mëdha. Ndërsa, premtimet për ulje dhe heqje tatimesh duket se nuk korrespondojnë me një rezultat zgjedhor më të mirë për asnjë nga partitë.

Premtimet buxhetore - fiskale dhe rezultatet zgjedhore, 2009-2021



Sipas vlerësimeve tona të efekteve prej premtimeve nga PS dhe PD për lehtësirat fiskale ndaj biznesit si dhe premtimet për shtim buxhetesh për sektorët dhe shtreat e ndryshme sociale, rezultatet sugjerojnë se:

- ulja e numrit të premtimeve të PD për alokimet buxhetore përkon me uljen me 13 pikë përqindje në rezultatit e PD në zgjedhjet e vitit 2013 në krahasim me 2009 dhe me uljen 6 pikë përqindje në 2017 në krahasim me 2013. Ndërkohë edhe pse ka rritur numrin e premtimeve për lehtësira fiskale në zgjedhjet 2013 dhe 2017 me respektivisht 3 pikë përqind dhe 11 pikë përqind, duket se nuk ka patur ndikim në rezultatit e tyre. Nëse analizën e bëjmë duke marrë për krahasim kostot buxhetore të premtimeve, duket se rezultatit i zgjedhjeve nuk shkon në proporcion të drejtë me shtimin e kostove të premtimeve. Kështu, vlera e kostove të llogaritura sipas premtimeve për zgjedhjet e viteve 2009²⁴, 2013²⁵ dhe 2017²⁶ respektivisht shkon në rritje me 123.4 miliard Lekë, 126 miliard Lekë, 147 miliard Lekë dhe 140.4 miliard lekë. Arsyeja e mospërkimit të rezultatit zgjedhor me tendencën në rritje të kostove të premtimeve vjen nga mungesa e informacioneve për votuesit. Natyrisht, që ndikimi në rezultatit zgjedhor nuk është i lidhur ngushtësisht vetëm me këtë element.

- rritja e numrit të premtimeve të PS për alokimet buxhetore përkon me rritjen me 0.5 pikë përqindje në rezultatit e PS në zgjedhjet e vitit 2013 krahasuar me 2009 dhe me rritjen 3.8 pikë përqindje në 2017

²⁴ <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/03/Rez2009Vendi.pdf>

²⁵ <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/permbledhese-2013.pdf>

²⁶ <http://results2017.cec.org.al/Parliamentary/Results?cs=sq-AL&r=r&rd=r14>


krahasuar me 2013. Numri i premtimeve për lehtësira fiskale në zgjedhjet 2013 dhe 2017 është i njëjtë dhe duket se nuk ka patur ndikim në rezultatin zgjedhor. Por, kur analizojmë krahasimin e tendencës së kostove të llogaritura buxhetore si efekt i premtimeve të PS, duket se ashtu si në rastin e PD-së nuk kanë lidhje me rezultatin zgjedhor, që ne gjykojmë se vjen për të njëjtën arsye të mungesës së një informacioni të tillë për masën e votuesve.

- në rastin e LSI mund të thuhet se efekti i premtimeve për heqje dhe ulje tatimesh dhe taksash nuk ka të njëjtën fuqi ndikuese në efektet e elektoratit të saj nëse nuk shikohet e lidhur edhe me premtimet buxhetore të orientuara në disa sektorë dhe jo për shumë sektorë. Tendenca e premtimeve për buxhetet të shtuara sektoriale në të gjithë zgjedhjet analizuara është orientuar drejt bujqësisë, arsimit, industrisë fason dhe shtresave të caktuara si ushtarakët, minatorët dhe drejt një ekonomie që mbështet punësimin e të rinjve. Duket se të gjitha këto, pavarësisht numrit në rënie të premtimeve për buxhetin kanë ndikuar në rritjen e rezultatit zgjedhor që në zgjedhjet e 2017 është rritur me 3.8 pikë përqind.

Megjithatë efekti i rezultatit që lidhet me premtimet zgjedhore për buxhetin dhe lehtësirat fiskale është e nevojshme ti nënshtrohet një studimi të thelluar.

Ne konstatojmë se një efekt i tyre e ka potencialin të ndikojë në ekuilibrin e votave zgjedhore në gara me konkurentë, që sipas sondazheve parazgjedhore kanë afërsi rezultati të pritshëm zgjedhor me njeri-tjetrin.

Krahasimi i kostove të premtimeve të rezultatit zgjedhor, 2009 - 2021



Sipas ecurisë së rezultatit zgjedhor, në Grafikun më lart shihet se nga një parashikim i rezultateve të zgjedhjeve në 2021, sipas rezultateve të konfirmuara nga KQZ²⁷ shihet se një ofertë elektorale me ulje të shpenzimeve buxhetore dhe rritje të premtimeve për lehtësi fiskale të PD korrespondon në rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2021 me një efekt 10.5 përqind më të lartë në krahasim me rezultatin e 2017.

²⁷ <http://www.kqz.gov.al/results/results2021.htm>

Për PS, me ulje të premtimeve për ofertën buxhetore, si dhe ruajtjen e një linje të njëjtë premtimesh si në zgjedhjet e 2017 për lehtësitë fiskale përkohë (po sipas mesatares së sondazheve) me një rritje me 0.4 pikë përqind.

Po kështu, për LSI një ulje e premtimeve për lehtësitë fiskale dhe për alokimet e buxhetit përkon me një ulje të rezultatit zgjedhor, me 7.5 pikë përqind.

Premtimet buxhetore - fiskale dhe rezultatet zgjedhore, 2009-2021

PREMTIMET FISKALE DHE REZULTATET ZGJEDHORE	PD				PS				LSI			
	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021
Ulje/Heqje Taksash	1%	4%	15%	12%	4%	9%	8%	8%	10%	10%	46%	18%
Shtim shpenzimesh buxhetore	54%	41%	35%	17%	21%	23%	44%	23%	34%	34%	22%	12%
<i>Rezultatet zgjedhore*</i>	<i>40.2%</i>	<i>30.6%</i>	<i>28.9%</i>	<i>39.4%</i>	<i>40.9%</i>	<i>41.4%</i>	<i>48.3%</i>	<i>48.7%</i>	<i>10.5%</i>	<i>10.5%</i>	<i>14.3%</i>	<i>6.8%</i>

* rezultati i zgjedhjeve të 2021 bazohet mbi rezultatet e raportuara nga KQZ
<http://www.kqz.gov.al/results/results2021.htm>

Kjo lidhje midis premtimeve buxhetore e fiskale dhe rezultateve zgjedhore në 3 zgjedhjet politike të fundit dhe rezultati për zgjedhjet e vitit 2021 duket se nuk është një lidhje e pandikuar edhe nga perceptimet e votuesve për secilën parti bazuar te orientimi politik i votuesve. Kjo është një arsye që duhet gjetur jashtë numrave dhe llogaritjeve të financave publike, pasi nëse votuesit do të llogaritnin votën e tyre bazuar te kostot financiare, asnjëra nga partitë nuk mund të jetë e besueshme për arsye të përkeqësimit të borxhit publik që do të rritet, në rast se zbatohen premtimet kur të qeverisë njëra nga partitë e mëdha.

Në rastin e efekteve të premtimeve nga PD, përkeqësimi i borxhit publik vjen si pasojë e politikës së uljeve të mëdha të barrës së taksave direkte dhe indirekte dhe për premtimet e PS, përkeqësimi vjen nga zbatimi i projekteve të mëdha infrastrukturore me fonde nga buxheti dhe ato në partnership me privatin. Ndërkohë, që premtimet e LSI janë plotësuese në përkeqësimin e borxhit publik nga uljet e taksave, por edhe alokimet për arsimin dhe bujqësinë, që kjo parti i trajton në marrëveshjen me PD si të domosdoshme në qeverisjen e ardhme, në rast të një koalicioni mes tyre.

Pikat e premtimeve buxhetore dhe fiskale të dy krahëve politikë janë të ngjashme nga formati i tyre.

Kështu, për lehtësitë fiskale le të diskutojmë rastin e premtimit/eve për tatimin mbi të ardhurat. Edhe pse duket sikur skemat janë të ndryshme për shkak të mekanizmit të tatimit të të ardhurave, në fakt zbatimi i tyre nuk ndodh ashtu si premtohet. *Tatimi me shkallë progresive* nuk zbatohet për gjithë të ardhurat dhe është progresiv vetëm për të ardhurat nga pagat. *Tatimi me shkallë të sheshtë* nuk zbatohet për gjithë të ardhurat dhe është zbatuar me një shkallë përkohësisht, pasi përvoja e vitit 2008²⁸, por dhe përvoja që presim të zbatohet në rast aplikimi të tij nuk do të ketë vetëm një shkallë, por do të jetë me të paktën dy shkallë.

Ndërkohë, ngjashmëria e tyre vjen nga sistemi tatimor shqiptar, i cili mbetet i njëjti model anemik në zbatimin e ligjit deri në fund, por edhe për arsye të mos zhvendosjes së barrës tatimore nga tatimet mbi konsumin drejt tatimeve mbi individin. Politika fiskale e partive politike nuk është pikërisht e lidhur me

²⁸ pagat e referencës e bënë tatimin e sheshtë të PD në progresiv me shumë shkallë, sipas niveleve të pagave për profesione dhe pozicionit të vendit të punës (specialist, teknik i mesëm dhe administrator)

vizione të tilla që rekomandohen prej të paktën një dekade me forcë edhe nga institucionet monitoruese ndërkombëtare, organizatat e biznesi, si dhe gjithë ekspertët me përvojë të financave publike dhe fiskalitetit, bashkë me aktorë të tjerë që ndikojnë te tatimpaguesit në përditshmërinë e tyre. Sistemi tatimor shqiptar është mjaft i ekspozuar ndaj parregullsive të administrimit, si pasojë e politikave të zbatuara keq me mbarëvajtjen organizative të tij, por edhe për mangësi në fokusin politik për të bërë tatimet sipas modeleve që ndryshojnë bashkë me ekonominë. Patronazhi i ngushtë i kryeministrave të dekadës së fundit për të drejtuar politikën fiskale bazuar te voluntarizmi është një nga ndikimet e mëdha në mosmbajtjen e premtimeve për politikën fiskale dhe vijimësinë e politikës së taksave të ulta.

Propozimet e partive kryesore përfshijnë edhe kreditimin tatimor për kategori shpenzimesh të përzgjedhura, apo mekanizma që konsiderohen të dëshirueshme nga shoqëria dhe bizneset.

Socialistët në këto zgjedhje, përveç uljes së tatimeve kanë premtuar:

- *“Nxitje transformimin e proceseve të prodhimit duke mbështetur blerjen e makinerive të industrisë 4.0 nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40%”, si dhe*
- *“ Paketën e inovacionit dhe IT, ku kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar apo i punësueshëm përfituesi”.*

Demokratët, përveç uljes së tatimeve kanë premtuar:

- *“Barazimin e TVSh në hyrje dhe dalje të produktit nga Fermeri dhe agroperpunuesi”, si dhe*
- *“Shpenzime të zbritshme sponsorizimet për artin, kulturën dhe sportin shqiptar”*

Edhe LSI, përveç uljes së tatimeve ka premtuar, se në koalicionin fitues me PD dhe aletatët ajo do të arrijë të realizojë:

- *“Rimbursim të 5% të çdo blerje me faturë, me përjashtim të shpenzimeve që kryhen në entet publike për Formalizimi ekonomisë dhe konsumit”, si dhe*
- *“Pajisjen me Kartën e Fermerit me zbatimin e së cilës bëhet zbritja automatike e pagesës së TVSH-së për imputet bujqësore (plehra kimik, fidanë, fara, naftë), për rimbursimet dhe subvencionet”*

Teknikisht, të gjitha këto skema të kreditimi të tatimeve në gjuhën fiskale konsiderohen si shpenzim tatimor, sepse partitë që do ja dalin të fitojnë zgjedhjet do të ulin vullnetarisht të ardhurat e buxhetit nëpërmjet mundësisë për bizneset të zbresin shpenzimet nga të ardhurat për llogaritjen e tatimit mbi fitimin. Për shembull, kreditimi i tatim fitimit nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40% e shton vlerën e shpenzimit të zbritshëm me 20% më shumë vlerë amortizimi se më përpara, duke llogaritur në këtë mënyrë 20% më pak fitim përpara tatimit.

Meqenëse një kreditim tatimor p.sh. nëpërmjet shpenzimeve të amortizimit apo edhe rimbursimeve të blerjeve etj., siguron një ulje të drejtpërdrejtë të tatim fitimit, kjo i bën politikanët më të lidhur me politikën e lehtësisë të tatimeve për grupe të veçanta biznesesh, duke shpresuar të fitojnë mbështetjen e tyre në momentin e zgjedhjeve.

Premtimi për kreditimet tatimore për disa shpenzime të caktuara të lidhura me përfitimet për një grup të synuar të bizneseve është një tjetër ulje e tatimeve përtej asaj që deklarohet si ulje nëpërmjet shkallëve tatimore më të ulta apo të zeruara.

4.2. Sfidat nga pandemia dhe rindërtimi në premtimet elektorale 2021

Viti 2020 tregoi, se ekonomia jonë dhe politikat sektoriale kishin integritet të brishtë në funksionimin e tyre dhe qeverisja që do të dalë nga zgjedhjet e vitit 2021 do të duhet të adresojë politika të reja për të përballur pasojat. Prioritetet e shpenzimeve të financimit të programeve buxhetore, duke pasur parasysh një mungesë në të ardhurat nga uljet e taksave vit pas viti, si dhe nga mangësitë në kulturën fiskale të krijuar me mundim në funksion të vullnetarizmit në pagimin e taksave, në të vërtetë ka vënë në diskutim efektivitetin e administrimit tatimor dhe mënyrën se si premtohen lehtësi fiskale, pa u menduar kur se si do të shpërndahet barra fiskale tani dhe për të ardhmen.

Premtimet për të adresuar direkt sfidat fiskale dhe paketa rigjallërimi të plota financiare dhe fiskale nga pandemia mungojnë në premtimet zgjedhore të vitit 2021.

PS dhe PD gjithsesi kanë bërë premtimin për vaksinimin e qytetarëve, por që në fakt nuk ka një premtim të strukturuar në programin elektorale të partive.

Ndërsa, premtimet për adresimin e rindërtimit janë bërë nga secila parti e madhe dhe janë më së shumti zbatim i projekteve që burojnë nga fondet e buxhetit, pa patur të prezantuar një plan më gjithëpërfshirës dhe që del përtej ndarjes politike dhe programore të partive.

Nga analiza e programeve të deklaruara si përmbledhje e zotimeve të drejtuesve të partive kryesore në të gjithë premtimet për shëndetësinë dhe për infrastrukturën, si sektorët që përfshijnë adresimin e efekteve direkte prej pandemisë dhe tërmetit të vitit 2019 nuk ka premtime të natyrës buxhetore përtej asaj që është parashikuar në buxhet sipas PBA 2021 – 2023. Ajo që mund të konsiderohet si një premtim i dhënë është koha e zbatimit të vaksinimit dhe koha e mbylljes së rindërtimeve, të cilat janë të parashikuara në buxhetin e shtetit 2021

Me rritjen e mundësive të një recesioni ekonomik të ardhëm në vendin tonë dhe te partnerët ekonomikë dhe tregtarë të Shqipërisë, apo në rastin e një goditje tjetër fatkeqësie natyrore/shëndetësore do të ketë nevojë që të modifikohet me shpejtësi kjo politikë e premtimeve aktuale të përjashtimeve dhe lehtësive fiskale dhe alokimeve buxhetore që e kanë lodhur sistemin tatimor. Lidhur me lehtësitë fiskale duket se në çdo proces elektorale tatimpaguesit janë të përkëdhelurit e politikës nëpërmjet premtimeve për ulje dhe lehtësi fiskale.

Por e gjitha kjo faturë elektorale që përmendet në këtë analizë do të jetë shumë e vështirë për ta kërkuar të paguhet në rastin kur borxhi publik dhe performanca fiskale nuk do të jenë më në funksion të përballimit të situatave të vështira të goditjeve të ekonomisë.

Përsa lidhet me borxhin publik, kjo situatë aktuale me një deficit buxhetor të prishëm në 2021 sa 6.5% e PBB-së nuk mund të adresohet duke marrë borxh për të paguar borxh, pasi faturat aktuale që po shlyhen nga buxheti i shtetit, si pjesë e premtimeve të kaluara tejkalojnë afër gjysmën e shpenzimeve kapitale.

Kështu, në rast zbatimi të skenarëve financiarë të bazuar në kostot e premtimeve zgjedhore, llogaritjet tregojnë se, krahas deficitit buxhetor të parashikuar në Relacionin e Buxhetit 2021²⁹:

- në vitin 2021 pritet të jetë sa 6.5% e PBB,
- në vitin 2022 do të jetë sa 2.9% e PBB dhe
- në vitin 2023 do të jetë sa 2.3% e PBB-së.

²⁹ <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20201022103723RELACION%20-%20BUXHETI%202021.pdf>

Nëse do të shtonim edhe deficitin buxhetor që shtohet nga premtimi i secilës parti politike kryesore, atëherë situata do të rezultojë si më poshtë:

- në rastin e premtimeve të PD deficitin buxhetor për vitin 2021, 2022 dhe 2023 do të shtohet edhe me 5.8 – 6.6 përqind më shumë nga sa është parashikuar, sipas viteve fiskale si më lart;

- në rastin e premtimeve të PS deficitin buxhetor për vitin 2021, 2022 dhe 2023 do të shtohet edhe me 5 – 5.8 përqind më shumë nga sa është parashikuar, sipas viteve fiskale si më lart;

- në rastin e premtimeve të LSI deficitin buxhetor për vitin 2021, 2022 dhe 2023 do të shtohet edhe me 1.5 – 1.7 përqind më shumë nga sa është parashikuar, sipas viteve fiskale si më lart.

Duket se llogaritjet mbi kostot dhe efektet buxhetore që rrjedhin prej premtimeve elektorale janë afër 1- 2 herë më të larta nga sa është përlogaritur të arrijë deficitin buxhetor pas vitit 2020, i konsideruar si viti i pandemisë. Ky fakt nuk përkon realisht me asnjë parashikim realist apo skenar të mundshëm për tu zbatuar, nëse të paktën ato nuk ulen si kosto premtimesh me 80% të tyre. Kjo zbritje nga kostot e premtimeve rezulton në rastin kur performanca e të ardhurave do të qëndrojë sipas parashikimeve makroekonomike e fiskale 2022-2024.

Çfarë duhet modifikuar te qasja e zotimeve elektorale me ndikim direkt në deficitin buxhetor?

Votuesit në gjithë fushatën zgjedhore nuk shprehin interesa direkte për informacionin ekonomik, pasi edhe nga testimet e kryera nëpërmjet informacioneve që dëgjohen prej tyre nga mediat mbizotëron tema politike e diskutimeve dhe deklaratave të drejtuesve politikë të vendit. Votuesit e përdorin informacionin politik në mënyra jo racionale dhe nuk përpiqen ti azhurnojnë bindjet e tyre subjektive përgjatë ndryshimit të dimensioneve të politikës dhe valencës politike të kandidatëve për deputetë. Duke u bazuar te kjo preferencë e votuesve shikohet një përshtatje e komunikimeve midis partive bazuar te mungesa e sinqeritetit dhe mungese llogaridhënie në paraqitjen e programeve elektorale.

Demokratët dhe socialistët duket se prezantojnë çdo arritje pozitive, si provë pozitive e administrimit të tyre ekonomik dhe nëpërmjet kësaj promovojnë politikën e tyre ekonomike dhe tatimore. Ndërkaq, ata tentojnë çdo keqësim të ekonomisë dhe buxhetit ata përpiqen ta transferojnë si dëshmi të keqe të politikave të kundërshtarit të tyre.

P.sh., përtej qasjes për premtimet mbi tatimin e individit, ato janë e njëjta formë dhe asnjera parti nuk ka arritur ta tatojë kapitalin dhe punën. Në vend të premtimeve për ulje të taksave duhet të dialogohet për konsensus dhe politika të përbashkëta midis palëve politike për rritje të taksave për të ardhurat dhe fitimet ndaj kapitalit për fituesit e mëdhenj të fondeve, së bashku me rritjen në mënyrë progresive të shkallëve tatimore për kompanitë sipas nivelit të të ardhurave të tyre. Dhe ajo që duhet të mbyllte diskutimin ndërpartiak për politikën tatimore duhet të jetë një zgjerim i taksës së pasurisë, pasi vetëm kështu do të ndihmohet buxheti i shtetit në financimin e përparësive të tilla si infrastruktura, nxitja e punësimit dhe krijimi i një ambjenti më të sigurt për biznesin duke patur mundësi në rritje për kujdesin shëndetësor dhe social.

Ideja për të adresuar përfundimisht atë që është një boshllëk masiv midis tatimit të individëve me të ardhura të ulta dhe tatimit të individëve me të ardhura më të larta, duhet të fillojë të mbushet edhe nëse nuk është premtuar nga partitë duke adresuar procesin fillestar tatimor dhe më pas duke i tatuar fitimet e

kapitalit si të ardhura të zakonshme. Kjo do të ishte një reformë e madhe e sistemit tonë, e cila është e nevojshme tani në kohën post pandemike më shumë se në asnjë kohë tjetër në tre dekadat e fundit.

Ne konstatojmë se nisur nga premtimet e deklaruara në vitin 2021, përveç faturës buxhetore të munguar për çdo premtim nevojitet që të deklarohet edhe sa do të jetë niveli i deficitit buxhetor dhe deri ku do ta çojnë nivelin e borxhit publik politikat e partive me premtimet e tyre në rast qeverisje.

Borxhi publik varet nga deficitit buxhetor dhe ulja e tij në rastin shqiptar është i pamundur të përmbushet për periudhën afatmesme. Ndërkohë, asnjë parti në kushtet e vitit pas pandemisë masive nuk shprehet në premtimet e veta lidhur me efektin që transmetojnë premtimet buxhetore në treguesin e borxhit publik.

Duke ndarë efektin në buxhetin e qeverisë me numrin e votave që janë ndikuar nga këto premtime zgjedhore, ne marrim vlerësime të papërpunuara të kostos buxhetore të zgjedhjeve të vitit 2021, si të zbatueshme në një nivel borxhi publik, që ato imponojnë deri në 40 mijë lekë/banor. Edhe nëse do të kemi rastin më të mirë të zhvillimit të ekonomisë, sipas prognozave të cilat përkujtojnë me ato të FMN, Bankës Botërore, Kuadrit Makroekonomik e Fiskal 2022 – 2024, duket se të hyrat e buxhetit shqiptar nuk mund të rriten më shumë se sa 1 përqind e PBB-së në vit për çdo 1% rritje të ekonomisë.

Në shikim të parë, duket se Demokratët ofrojnë forma më gjithëpërfshirëse dhe potencialisht më bujare të lehtësimit të taksave për një grup më të gjerë të përfituesve. Gjithashtu edhe Socialistët kanë miratuar më herët në Kuvend, në vitin 2020 politika lehtësimiti tatimore për biznesin e vogël.

Por le të analizojmë më tej propozimet konkrete dhe të shohim çfarë kostoje dhe çfarë përfitimi kanë ato.

Nga një analizë e përjashtimeve fiskale për biznesin e vogël e miratuar nga PS, që hyri në fuqi më 1 Janar 2021, rezulton se për çdo 100 lekë qarkullim, përfitimi i biznesit është mesatarisht 1.6 lekë TVSH për 100 lekë qarkullim dhe 0.4 lekë për 100 lekë xhiro, në total 2 lekë për 100 lekë qarkullim (2% përfitim).

Të tre partitë do të eliminojnë tatimin e pagës për një nivel poshtë 40 mijë lekë/muaj (PS), 36 mijë lekë/muaj (PD) dhe 35 mijë lekë/muaj (LSI).

Ndërkohë, anulimi i taksës së qarkullimit dhe akcizës për karburantet për përdorim nga automjetet përputhet me pikëpamjen afatgjatë të PD se tatimet Pigouviane³⁰, për mallrat që shihen si potencialisht të dëmshme për shoqërinë mund të jenë regresive, duke rritur koston për familjet me të ardhura më të ulëta dhe bizneset e vogla.

Premtimi i LSI për të shtuar një tatim të ri, ai i 1% mbi fitimin e tatimpaguesve të mëdhenj është mjaft i gjerë, veçanërisht sepse ata propozojnë të financojnë me këto të ardhura kualifikimin profesional.

Ndërsa, në analizën e premtimit të uljes së tatimit mbi fitimin nga 15% në 9%, si dhe tatimit mbi pagën nga 23% dhe 13% në 9% duket se ka ndikim neto në përjashtimin e bazës së gjerë të tatimpaguesve të tatimeve mbi të ardhurat nga puna dhe kapitali, duke e përqendruar uljen tatimore te familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, por duke mos kufizuar nga ana tjetër shumat e përfitimeve për tatimpaguesit me të ardhura të larta.

³⁰ Një tatim Pigouvian është një kosto shtesë nga buxheti për aktivitete ekonomike që krijojnë efekte të dëmshme shoqërore

Në të kundërt, propozimi i PS për të vendosur një moratorium deri në 2029 për mosrritjen e TVSH dhe tatimeve mbi të ardhurat në grupin e bizneseve me të ardhura të ulëta tenton të shpërndajë përfitimet në një grup më të gjerë të bizneseve, por edhe të krijojë mundësinë për të vepruar mekanizmat e dixhitalizimit të tatimeve.

Sidoqoftë, të dy krahët politikë përqendrojnë përfitimet e tyre në qytetarë me të ardhura më të ulëta dhe të mesme, kështu që, me të vërtetë, nuk ekziston shumë ndryshim mes tyre lidhur me qasjen ideologjike.

Premtimi i të mirave publike dhe zbatimi i programeve politike nuk janë thjesht strategji efektive për të fituar zgjedhjet. Përveç përqendrimit në inovacionet e politikës ekonomike është e rëndësishme të kuptojmë tiparet e kontekstit politik të trashëguar, që e bëjnë të vështirë të kemi politika miqësore për zhvillimin e vendit dhe ruajtjen e integritetit të qeverisjes. Nga hulumtimet e zgjedhjeve të mëparshme, kemi provuar se premtimet elektorale të drejtuesve të partive kryesore nuk janë të hapura të adresojnë qartë dhe në mënyrë të detajuar për votuesit e tyre propozimet ekonomike dhe investimet.

Ne duke analizuar premtimet e drejtuesve politikë të partive në terrenin zgjedhor kemi arritur në një konstatim të tillë që tregon se asnjë nga partitë nuk u siguron votuesve disa nga informacionet që u duhen për të vlerësuar vlerat reale, kostot dhe përgjegjësinë e premtimeve të kandidatëve për deputetë të kuvendit të Shqipërisë, për të dy krahët e politikës.

Nëpërmjet premtimeve për rritje ekonomie, pritshmëria e publikut është që do të shoqërohet edhe me reformat strukturore drejt një modelimi të ndryshuar të ekonomisë. Por, të zgjerosh ekonominë duhen bërë njëkohësisht disa reforma (përmirësime/sistemime) drejt (a) modelimit të ekonomisë, (b) reformimit të sistemit tatimor, (c) përmirësimit të infrastrukturës, (d) rigjallërimit të prodhimit dhe eksporteve, (e) mbështetjes së individëve me të ardhura të ulta dhe të mesme, (f) përshtatjen me inovacionin dhe edukimin me sistem zinxhir të brezit të ri, (g) thjeshtimin e barrës burokratike.

Të gjitha këto kanë qenë në objektin e punës së qeverive të dekadës së fundit, por asnjëra prej reformave nuk është përfunduar dhe nuk ka dhënë efektet e saj në ekonomi, ose sepse ka qenë e shkëputur nga reformat e tjera, ose sepse secila qeveri ka zhvilluar ato reforma që ka premtuar dhe të shkëputura nga premtimet e partisë tjetër. Mungesa e konsensualitetit për të bërë reforma për vendin dhe jo për maksimalizim të votës dhe përfitimeve për grupe të ngushta na ka lënë me premtime të porealizuara dhe me një ekonomi dhe shoqëri, që i dorëzohet në vijimësi dëshirave të drejtuesve të qeverive. Ky dorëzim shihet në rastin e tendencës për realizimin e premtimeve në vitin/muajt e fundit të qeverisjes së partive, apo rritjen e fondeve në periudhat parazgjedhore, që në fakt nuk synojnë realizimin, por thjesht mashtrimin për tu konsideruar prej votuesve se premtimi po mbahet.

Kështu, p.sh. kur qeveria përpiket të synojë përfitime për grupe më të përgjegjshme votuesish, efekti i trajtimit nuk rezulton se funksionon njësoj edhe për grupet e tjera të votuesve. Nëse merret vendimi se do të bëhet rritje page e mësuesve dhe mjekëve, apo rritje pensionesh fakti që kategoritë e tjera nuk trajtohen njësoj si këto dy kategori e bën më pak të mundshme që mjekët dhe mësuesit të jenë të ndikuar njësoj si grupe të tjera më pak të informuar (p.sh. inxhinierët), pasi ata janë bërë më të përgjegjshëm ndaj politikave para elektorale të transfertave prej buxhetit. As burimet ekonomike dhe as trajtimi buxhetor ndaj grupeve të caktuara nuk sugjerojnë që ato mund të jenë në gjendje të ndikojnë rrjedhat e votave si një politikë buxhetore, që bazohet mbi interesa momenti. Për më tepër, shumica e votuesve i përkasin grupit që kanë tashmë një informacion më të plotë dhe jo vetëm në një moment të lidhur me premtimet zgjedhore.

PËRFUNDIME

Procesi i deklarimit të premtimeve dhe pritja për miratim me anë të votës nga qytetarët duhet të bazohen në analizën dhe diskutimin e cilësisë më të lartë të secilit premtim dhe të përfshijë një ekuilibrim të kostos dhe përfitimit. Por ky proces nuk duket se po ndodh duke konstatuar se qasjet e njerëzve drejt premtimeve të liderëve të partive priren drejt komenteve impulsive të tyre, që në thelb shprehin se zotimet e sotme të tyre janë të mbajtura peng nga proceset e kaluara personale politike.

Nisur nga niveli i besueshmërisë të premtimeve zgjedhore në vitet 2009-2017³¹, ne konstatojmë se mangësitë në informacionin e votuesve lidhur me përgjegjshmërinë financiare të premtimeve të politikanëve vijon të jetë problem i njëjtë si edhe në zgjedhjet përpara 2021. Politikanët nuk kanë reflektuar as në këto zgjedhje për të premtuar atë që mundet realisht të realizohet.

Votuesit në këto zgjedhje nuk kanë dëgjuar shumë diskutime të natyrës ekonomike për premtimet, por më së shumti edhe interesimi i mediave dhe rrjeteve sociale ka qenë për informacione rreth platformave të kandidatëve. Ndërsa, lidhur me raporte të pjesshme apo të plota për kostot buxhetore të premtimeve dhe nivelin e vërtetësisë së tyre duket se nuk është ndërtuar ende fryma e duhur për të tërhequr interesim më të madh se ai për diskutimet politike.

Megjithëse nuk mund të shprehemi me siguri se sa informacion ekonomik, si dhe specifikisht sa informacion rreth kostove financiare të premtimeve të kaluara ka arritur të jetë pjesë e diskutimeve të votuesve, ne vlerësojmë se preferencat ndaj liderëve politikë ndjekin teorinë standarde të simpatizimit të lidhur me afërsinë e bindjeve politike, madje edhe në një nivel që mund të jetë surprizë në këto zgjedhje, nisur nga fakti i ndikimit të efekteve të pandemisë.

Në fushatën zgjedhore të vitit 2021, numri i premtimeve elektorale të partive kryesore është i njëjtë me sasinë e premtimeve të deklaruara në vitin 2009. Ndërkaq, konstatohet një rënie me të paktën 3% e premtimeve specifike në krahasim me zgjedhjet e vitit 2017. Konkureshmëria më e fortë e premtimeve midis partive është në drejtim të arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, turizmit dhe politikave fiskale dhe buxhetore.

Pikat më të forta në programin elektorale të PD janë *punësimi dhe politika e jashtme*, ku përfshihet edhe integrimi, por të pasuara në mënyrë shumë të fortë mbështetëse nga propozimet për buxhetin dhe lehtësitë tatimore. *Premtimet buxhetore* janë pjesa më e prekshme nga totali i premtimeve dhe përfshijnë sektorë të rëndësishëm të orientimit të programeve të PS, të tilla si: arsimit, infrastruktura, dixhitalizimi.

LSI në premtimet e deklaruara në zgjedhjet e vitit 2021 synon të përçojë optimizëm të bazuar në *programin zgjedhor prej 5 pikash* që përmbledh qasjen për formalizim nëpërmjet politikës së rimbursimit të blerjeve, zerimit të TVSH për prodhimet e sektorit të bujqësisë, qasjen drejt arsimit profesional dhe rritjes së infrastrukturës arsimore, si dhe nxitjes së politikave të anti-shpopullimit të vendit nëpërmjet programit për stimulimin e lindshmërisë në vend.

Në zgjedhjet e vitit 2021, premtimet e partive politike janë mesatarisht të besueshme në nivelin prej 25 përqind me një rënie të nivelit me 11% më poshtë se zgjedhjet e vitit 2017. Premtimet pak të besueshme janë mesatarisht në nivelin prej 47 përqind dhe janë 7% më poshtë se zgjedhjet e vitit 2017. Premtimet jo të matshme janë mesatarisht në nivelin 28 përqind, por me një rritje të tyre prej 18 përqind krahasuar me 2017.

³¹ <https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/03/PERGJEGJESHMERIA-FINANCIARE-E-PREMTIMEVE-TE-POLITIKES-SHOIPTARE-2009-2017.pdf>

Një ndryshim kaq disproporcional i nivelit të besueshmërisë është tregues i mosreferimit të partive ndaj qasjeve vizionare dhe strategjike të vendit. Ky tregues vjen me përkeqësim në këto zgjedhje krahasuar me zgjedhjet e kaluara.

Në një analizë të tërësisë së hartimit të premtimeve bazuar te qëllimet strategjike, si dhe nisur nga nevojat për tu bërë një ekonomi konkurruese në tregun rajonal shikohet se ka një tendencë të bërjes së premtimeve që i shërbejnë pak vizionit të vendit, pasi nxitja më e madhe e premtimeve është të stimulojnë kërkesën e votuesve nëpërmjet premtimeve të lehta për tu realizuar (premtimet fiskale) dhe të arritshme brenda mandatit qeverisës.

Premtime e përsëritura nga zgjedhja në zgjedhje përbëjnë 15% të premtimeve të politikanëve shqiptarë janë një *modus vivendi* midis parive politike konfliktuale të vendit. Përtej premtimeve të ngjashme, secila nga partitë nuk arrijnë dot të prezantojnë qasje të ndryshme për arritjen e të njëjtave premtime. Ndërsa, premtojnë shtim buxhetesh, ato nuk qartësojnë se si do të arrihet që ky buxhet i shtuar të konvergojë me objektivin e premtimit.

Në rastin e premtimeve nga pozitat e një opozitari, secila nga partitë shihet se premtion me shumicë për ulje dhe heqje tatimesh e taksash, për investime dhe shtim të buxhetit për sektorët ku punojnë e jetojnë një pjesë e madhe e votuesve, si dhe për arsimin, gruan dhe rininë për ti shërbyer maksimalizimit të votës, pa hyrë në analiza për një masë të pranueshme dhe të realizueshme. Kur partitë politike premtojnë në pozitat e një qeveritari që kërkon të rrijë ende në zyra për të vijuar përmbushjen e premtimeve, vërehet se partitë kanë ndryshime në orientimin sektorial të premtimeve. Përgjithësisht premtimet e tyre orientohen në ato projekte që janë ende në proces dhe të buxhetuara. Por, ndërkohë harta e shpërndarjes së premtimeve nuk ka polarizimin dhe shpërndarjen e tyre sektoriale, që vërehet kur janë në opozitë.

Në premtimet elektorale 2021 shihet se PD ka vlerën më të lartë të efekteve në shpenzimet buxhetore në krahasim me PS dhe LSI. Premtimet për shpenzime në sektorë dhe shtresa të ndryshme sociale arrijnë në një vlerë absolute vjetore prej 140.7 miliard lekë. Ndërsa efekti i premtimeve në të ardhurat arrin në 28.2 miliard lekë, që llogaritet se do ti gjenerojnë premtimet për rritjen ekonomike, për rritjen e punësimit, si dhe për investime në sektorë ku ekonomia e rimerr investimin.

PS arrin që të ketë një efekt prej 100.4 miliard lekë në vit në shpenzimet buxhetore në rast se do të zbatohen premtimet elektorale 2021. Ndërsa të ardhurat që mund të gjenerohen nga zbatimi politikave të zhvillimit ekonomik, investimeve dhe punësimit llogariten të jenë në 9.2 miliard lekë në vit. LSI ka një ndikim të kostos sa 1/3 e partive të mëdha.

Sipas ecurisë së procesit zgjedhor, nga një parashikim i rezultateve të zgjedhjeve në 2021, sipas tre sondazheve nga TV të ndryshme shihet se një ofertë elektorale me ulje të shpenzime buxhetore dhe rritje të nivelit të premtimeve për lehtësi fiskale përkon në rezultatin e sondazheve të 2021 me një efekt prej 11.2 përqind më të lartë në krahasim me rezultatin e 2017. Kjo lidhje midis premtimeve buxhetore e fiskale dhe rezultateve zgjedhore në 3 zgjedhjet politike të fundit dhe rezultati i mesatarizuar sipas sondazheve për zgjedhjet e vitit 2021 duket se nuk është një lidhje e pandikuar edhe nga perceptimet e votuesve për secilën parti bazuar te orientimi politik i votuesve.

Premtimet e politikanëve edhe në 2021 ende servirin informimin e zbukuruar dhe joreal financiar në bërjen e premtimeve buxhetore dhe fiskale në mënyra dhe forma jo racionale dhe i azhurnojnë premtimet e tyre në përputhje me rrethanat dhe kërkesat momentale të votuesve duke dalë jashtë kornizave të dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara për të ardhmen e vendit. Ky konstatim bazohet te fakti i rëndimit të

deficitit buxhetor të një viti fiskal post pandemie me një nivel barre deficitare që varion nga 1 – 2 herë më të lartë nga parashikimet buxhetore.

Votuesit, duke pasur parasysh informacionin rreth platformave të kandidatëve, me gjasa preferojnë kandidatët, alokimet buxhetore të të cilëve janë më afër pikave të tyre ideale ekonomike dhe sociale.

Ne gjithashtu konstatojmë një mënyrë orientimi të premtimeve të partive politike në fushatën zgjedhore drejt diskursit politik gjithnjë e më shumë të bazuar në strategjinë për tu krahasuar me epërsitë ndaj kundërshtarit politik në vend të krahasimit me premtimet e porealizuara, si dhe me mospërbushjen e objektivave strategjike.

Analiza jonë e re e kostos buxhetore që krahason premtimet e partive politike me dokumentet buxhetore dhe parashikimet afatmesme të financave publike shqiptare tregon se egziston një lidhje mes premtimeve të kandidatëve me përfitime indirekte të të drejtës së votës në këmbim të programeve partiake të vlerave të transfertave të buxhetit duke u konsideruar ky realitet i politikës si një strategji elektorale me kosto më efektive se sa premtimet e vështira për tu realizuar.

Programet politike zgjedhore kanë qasje të dukshme të orientohen drejt një përfitimi indirekt të votës nëpërmjet lançimit të premtimeve që prodhojnë një efekt të rremë fiskal nëse do të aplikoheshin nga buxheti i shtetit. Ky konstatim është i bazuar te premtimet për rritje të pagave dhe pensione, buxheteve të pamundura për tu zgjeruar në nivelet e premtuara për bujqësinë dhe arsimin, premtimet e reja për infrastrukturën dhe shkurtimet e normave tatimore, si dhe pamundësia për të garantuar si të realizueshme premtimet për investimet e huaja. Në rast zbatimi të premtimeve të tilla nga partitët kur të marrin detyrën për të qeverisur, atëherë do të duhej të kishin një rritje performance buxhetore deri në një nivel mbi 100% në raport me rritjet faktike në buxhetet vjetore të dekadës së fundit.

Premtimet zgjedhore me kosto financiare jashtë mundësive të buxhetit të vendit, sipas parashikimeve në dokumentet kryesore strategjike për financat e vendit vijnë të mos kenë shenja reagimi edhe pas prezantimeve të raportimeve të ndryshme nga gazetaria investigative, raportet e ndryshme të analizave ekonomike, si edhe nga vetë prezantimi që ne bëmë në raportin e parë të publikuar për koston e llogaritur të premtimeve zgjedhore. Kjo tendencë e premtimeve të politikës shqiptare edhe pse nuk ka të njëjtin dimension midis partive kryesore është e dukshme se nuk është një zgjedhje e re, por mbetet një formë e mosreflektimit të politikanëve nga qasja e tyre për të shmangur dialogun financiar me votuesit e tyre.

Kjo situatë *status quo* e mosndryshimit të modelit të ofertës politike sugjeron një rol të mundshëm për organizatat joqeveritare dhe mediatike për të siguruar këtë lloj informacioni të politikave, në mungesë të stimujve të politikanëve për ta bërë këtë.

Kjo fushatë zgjedhore e vitit 2021 sugjeron gjithashtu që një mënyrë e mundshme për nxitjen e politikanëve për të ndjekur strategji të bazuara në politikën e premtimeve të mundshme për tu realizuar nga buxheti i shtetit është heqja dorë prej synimeve për të blerë premtimin e votës së votuesve në këmbim të premtimeve jo reale, duke rritur kështu shkallën e pajtueshmërisë dhe duke e bërë modelin e premtimeve joreale një strategji jofunksionale për zgjedhjet e ardhme.

SHTOJCA

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PD, 2021³²

PREMTIME PËR ARSIMIN, GRUAN DHE RININË

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Rritje të pagës 50 % për stafet akademike. Paga 900 Euro pedagogëve, 1.300 Euro profesorëve	±	Po	PBA 2021-2023 ³³			Nuk përmendet ky nivel
2	Rritja e pagës së arsimtarëve me 60 %, asnjë mësues pagë më të vogël se 700 Euro/muaj ³⁴	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk përmendet ky nivel
3	Grante për institucionet publike të Arsimit të Lartë ³⁵	√	Po	PBA 2021-2023			
4	Ofrimi i arsimit të lartë të digjitalizuar, me investim në vlerën 40 milion US.D ³⁶	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk përmendet ky nivel
5	Të rinjve që duan një profesion, do ta mësojnë atë gjatë periudhës së arsimit të mesëm	±	Po		S.K.P.A 2019-2022 ³⁷		Permendet në strategji
6	Tekstet shkollore do të jenë falas për të gjithë ciklin parauniversitar ³⁸	√	Po	PBA 2021-2023			

³² <https://pd.al/arkive/>

³³ <https://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2021-2023-faza-iii/>

³⁴ përfitues 36 mijë arsimtarë. Të ardhura dhe mirëqenie për 36.000 familjet e mësuesve tanë të arsimit parauniversitar.

³⁵ për modernizimin e infrastrukturës fizike e pedagogjik

³⁶ me fokus labororët e parqet e teknologjisë së informacionit, zona me internet falas dhe pajisje të teknologjisë së informacionit

³⁷ <https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/15.Strategjia%20Sektoriale%20p%C3%ABr%20Arsimin%20Parauniversitar%202015%20-%202020.pdf>

³⁸ 350.000 nxënës

7	Bursë të plotë për çdo student që vjen nga familje me të ardhura nën 64.000 lekë dhe bursë 50% për studentët nga familje me të ardhura mbi 64.000 Lekë	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk përmendet ky nivel
8	Do të hapet fakulteti i ri mjekësor në Shqipëri	?	Po				Nuk ka referencë
9	Hapje vende të reja pune për të rinjtë, duke financuar arsimin profesional dhe duke ulur taksat për investitorët	±	Po		S.K.P.A 2019-2022 ³⁹		Përmendet në strategji
10	10 mijë studentët më të mirë do të përfitojnë 1 vit praktikë pune të paguar 30.000 lekë/ muaj	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk përmendet ky nivel
11	Do të aplikojmë programin e trajnimit të dyfishtë profesional për të gjithë të rinjtë	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
12	Subvencionim 100 % për tarifat e studimit Bachelor dhe Master	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk përmendet ky nivel
13	Zerim tarifash për 90 % të studentëve	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
14	Pavarësi për universitetet dhe liria e nevojshme akademike me ligj të ri	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
15	Do të arsimojmë çdo fëmijë, pavarësisht statusit të tyre social, ekonomik apo aftësive të kufizuara	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.A.P-U 2014-2020		Përmendet në strategji
16	Tablet/laptop/kompjuter për çdo familje	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
17	Program pas shkolle dhe ushqim në orët shtesë	√	Po	PBA 2021-2023			
18	Do të mundësojmë 20 trajnime profesionale për rininë shqiptare dhe 5	?	Po				Nuk ka referencë të matshme

³⁹<https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/15.Strategjia%20Sektoriale%20p%C3%ABr%20Arsimin%20Parauniversitar%202015%20-%202020.pdf>

	gjuhë të huaja, të gjitha online						
19	5.000 bursa të plota në vit do t'u ofrohen të gjithë të rinjve, që kanë pamundësi ekonomike për të ndjekur studimet e larta	±	Po	PBA 2021-2023			Përmendet në PBA, por jo në këto nivele
20	Nuk do të ketë të rinj, bija dhe bij shqiptarësh, që do të mbeten pa studiuar për shkak të pamundësive ekonomike të familjeve të tyre	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.A.P-U 2014-2020		Përmendet në PBA e Strategji, por jo në këto nivele

PREMTIME PËR SHËNDETËSINË

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program elektoral	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Paga e infermierëve do të bëhet 700 Euro, paga e mjekëve do të bëhet 1.200 Euro, paga e mjekëve specialistë do të bëhet 950 Euro	±	Po	PBA 2021-2023		Përmendet në PBA, por jo në këto nivele
2	Riorganizimi i shërbimit të shëndetit publik sipas standardeve ndërkombëtare	±	Po	S.K.SH. 2016-2020 ⁴⁰		Përmendet te Strategjia
3	Rritja e kapaciteteve trajnuese për mjekë, për më shumë mjekë	√	Po	P.ZH.S. 2015-2020 ISHP ⁴¹		
4	Finalizimi projektit të Kartës së Pacientit, për të zgjedhur shërbimin shëndetësor ⁴²	√	Po	FSDKSH ⁴³		
5	Politikat e tjera të shëndetit publik që do të kenë të bëjnë me shërbimin ⁴⁴	√	Po	S.K.SH. 2016-2020	DRAFT LIGJI ⁴⁵	
6	Bazë ligjore dhe kontroll për ilaçe të cilësisë së lartë	?	Po			Nuk ka referencë të matshme
7	Ilaçet do të rimbursohen sipas diagnozës dhe jo sipas skemës	±	Po	P.ZH.S. 2015-2020 ISHP		Referencë e paplotë

⁴⁰https://extranet.who.int/countryplanningcycles/sites/default/files/planning_cycle_repository/albania/draft_strategt_albania_2016-2020.pdf

⁴¹ <http://ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/05/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik.pdf>

⁴² Plani tonë konkret për shëndetësinë është: paraja ndjek pacientin

⁴³ https://www.fsdks.com.al/images/stories/baza_ligjore/Karta%20Shqiptare%20e%20te%20Drejtave%20e%20Pacienteve.pdf

⁴⁴ qoftë rajonalizimin e shërbimit spitalor, qoftë aksesin te mjeku i familjes

⁴⁵ http://konsultimipublik.gov.al/documents/RENIK_240_ligji%20ri%20spitaleve%204%2012%202019.doc

	aktuale kufizuese që lë jashtë saj shumë medikamente për njerëzit					
8	Një skemë për rimbursimin e familjeve të zhytura në borxhe për t'u kuruar nga Covid-19 ⁴⁶	?	Po			Nuk ka referencë të matshme

PREMTIME PËR EKONOMINË⁴⁷

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Biznesi i vogël dhe rregullimi i problemit të pronave janë dy prioritetet e para të qeverisë së ardhshme	√	Po		S.ZH.B.I. 2014-2020 ⁴⁸	SKZHI II	
2	Hapja e 110 mijë vendeve të reja të punës me fokus punësimin e të rinjve ⁴⁹	±	Po	KMF 2022-2024 ⁵⁰	ERP 2021-2023 ⁵¹	S.K.P.A. 2019-2022	Jo e plotë sipas KMF, ERP
3	Rritja e pagës minimale në 36 mijë lekë dhe deri në fund të mandatit 50 mijë lekë ⁵²	±	Po	KMF 2022-2024	ERP 2021-2023		Jo e plotë sipas KMF, ERP
4	Vendosja e taksës së sheshtë, duke tërhequr investimet e huaja dhe duke nxitur sipërmarrjen rinore dhe inovacionin	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
5	Do të dyfishojmë kontributin e sektorit minerar në ekonomi	±	Po	KMF 2022-2024	P.I.J-U 2016-2025	ERP 2021-2023	Nuk është e plotë
6	Përmirësim të ndjeshëm të klimës së biznesit, luftës kundër korrupsionit dhe shmangies së	√	Po		S.ZH.B.I. 2014-2020 S.N.K.K. 2015-2020	SKZHI II	

⁴⁶ <http://ata.gov.al/2021/03/31/basha-ne-nje-familje-te-vjeter-korcare-fajin-per-gjendjen-e-shendetesise-e-ka-keqqeverisja/>

⁴⁷ <https://dosja.al/programi-i-pd-se-per-energjine-basha-basha-shqiperia-ka-ngecur-ne-vendnumero-me-ramen-keto-8-vite/>
<https://shqiptarja.com/lajm/lulzim-basha-prezanton-programin-e-pdse-per-biznesin>

⁴⁸ <https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/5.Strategjia%20e%20Zhvillimit%20t%C3%AB%20Biznesit%20dhe%20Investimeve%202014%20-%202020.pdf>

⁴⁹ 4 inkubatorë biznesi brenda 4 viteve, për të zhvilluar ide inovatore dhe për të promovuar sipërmarrjen e punësimin në vend

⁵⁰ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/Kuadri-Makroekonomik-e-Fiskal-p%C3%ABr-periudh%C3%ABn-2022-2024-VKM-Nr.-7-dt-13.1.2021-.pdf>

⁵¹ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/20/b3be06e6-4b49-406c-b3b3-5e69563107a4>

⁵² <https://shqiptarja.com/lajm/basha-me-grate-ne-dajt-paga-minimale-ne-fund-te-4vjecarit-400-euro>

	mbivendosjeve së kompetencave të agjencive të ndryshme						
7	Do të ulim numrin aktual të licencave dhe lejeve të biznesit që jepen sot nga shteti, si dhe do përgjysmojmë afatet ligjore të çdo leje nga 60 ditë në 30 ditë	?	Po				Nuk ka referencë të matshme

PREMTIMET PËR MJEDISIN DHE TURIZMIN⁵³

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Turizmi prioritet kombëtar, mbështetje me masa financiare, ligjore, fiskale	√	Po		S.K.ZH.Q.T 2019-2023 ⁵⁴	SKZHI II PKIE 2019-2021	
2	Turizmi do të ketë një rritje të kontributit në PBB nga 8% në 10%	±	Po	KMF 2022-2024	S.K.ZH.Q.T 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
3	TVSH prej 6% mbi të gjitha kompanitë në sektorin e turizmit	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023		Referencë e paplotë
4	Rritje vjetore 15% e turistëve të huaj	±	Po	KMF 2022-2024	S.K.ZH.Q.T 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
5	Dyfishim i numrit të të punësuarve në turizëm ⁵⁵	±	Po	KMF 2022-2024	S.K.ZH.Q.T 2019-2023	ERP 2021-2023 INSTAT ⁵⁶	Referencë e paplotë
6	Një paketë financiare dhe fiskale për të kualifikuar fuqinë punëtore	√	Po		S.K.ZH.Q.T 2019-2023		
7	Angazhohem të dyfishojmë kapacitetet akomoduese	±	Po		S.K.ZH.Q.T 2019-2023		Referencë e paplotë
8	Do të dyfishojmë kohën e qëndrimit të turistëve të huaj në vendin tonë	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
9	Moratoriumi i Gjetisë do të hiqet	?	Po				Nuk ka referencë të matshme

⁵³ <https://pd.al/2021/02/basha-programi-yne-shqiperia-fiton-turizmin-me-angazhime-serioze/>

⁵⁴ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-413-2019-per-strategjine-kombetare-per-turizmin-2019-2023.pdf>

⁵⁵ nga 40.000 në 80.000 vende pune

⁵⁶ http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra_.pdf

PREMTIME PËR BUJQËSINË

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Ti kthejmë fshatrat dhe zonat rurale të vendit në faktorë zhvillimi	√	Po		S.N.ZH.R.B 2014-2020 ⁵⁷		
2	Subvencion i përvitshëm ndaj fermerëve me një buxhet prej 100 milion eurosh në vit	±	Po	PBA 2021-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020		Nuk është si prioritet në këto nivele
3	Do të financojmë 50 milionë Euro të tjera çdo vit për infrastrukturën bujqësore, krahas financimeve të Bashkimit Europian	±	Po	PBA 2021-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020		Nuk është si prioritet në këto nivele
4	Do të përjashtohen nga detyrimet fiskale, për tre vitet e para të aktivitetit, të gjitha sipërmarrjet e krijuara nga të rinjtë e shkolluar në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
5	Do të jepen grante dhe përfitime fiskale fermtat dhe sipërmarrjet e krijuara nga të rinjtë e diplomuar në arsimin e mesëm profesional dhe atij të lartë në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit	±	Po	PBA 2021-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020		Nuk është si prioritet në këto nivele
6	Lehtësira fiskale në procedurat e licensimit të aktivitetit të peshkimi dhe akuakulturës	?	Po	PBA 2021-2023	S.K.P. 2016-2021 ⁵⁸		Nuk ka referencë
7	Barazimin e TVSh në hyrje dhe dalje të	?	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020	Nuk ka referencë

⁵⁷ https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA_NDERSEKTORIALE.pdf

⁵⁸ https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/STRATEGJIA_KOMBETARE_E_PESHKIMIT.pdf

	produktit nga Fermeri dhe agroperpunuesi						
8	Taksa e tokës do të zerohet për të gjithë fermerët që e punojnë tokën e tyre	?	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020	Nuk ka referencë
9	Karta e identitetit do të shërbejë edhe si NIPT i fermerit	?	Po		S.S.M.F.P 2019-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020	Nuk ka referencë
10	Akses i plotë e i lirë në tregje, çmontim monopoleve të tregjeve dhe heqjen e çdo pengese që fermeri të arrijë ta çojë prodhimin në treg	?	Po		S.S.M.F.P 2019-2023	S.N.ZH.R.B 2014-2020	Nuk ka referencë
11	Do të fuqizojmë aksesin në tregjet e huaja, duke ngritur Agjencinë e Promovimit të Eksporteve Shqiptare.	±	Po		S.N.ZH.R.B 2014-2020		Referencë e paplotë
12	Zgjidhja e problemeve të përmbytyjeve të qyteteve tona	√	Po	PBA 2021-2023			

PREMTIME PËR POLITIKËN E JASHTME

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Do ta çojmë Shqipërinë pa ndalur drejt anëtarësimit në Bashkimin European	√	Po			P.K.I.E. 2019-2021	
2	Partneritet strategjik me SHBA-në	√	Po				
3	Ndërtimi dhe nxitja e bashkëpunimit rajonal efektiv për fuqizimin e tregut të punës dhe tregut rajonal	√	Po			P.K.I.E. 2019-2021	SKZHI II
4	Marrëveshja e kthyer nga Gjykata Kushtetuese duhet të shkojë në Gjykatën Ndërkombëtare	√	Po				KUVENDI
5	Brenda gjashtë muajve të parë qeverisëse, do të bëjmë të mundur mbajtjen e Konferencës së parë	?	Po				Nuk ka referenca të matshme

	ndërqeveritare dhe do të rikthejmë Ministrinë e Integritit						
6	Kostot e shtuara financiare që kanë ulur ekonominë, tregtinë midis Kosovës dhe Shqipërisë do të zhduken ⁵⁹	?	Po				Nuk ka referenca të matshme

PREMTIME PËR ENERGIJINË⁶⁰ DHE INDUSTRIJË

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Do të ulim faturën e energjisë elektrike për 70% të familjeve shqiptare ⁶¹	?	Po				Nuk ka reference dhe nuk mund të matet
2	Do të liberalizojmë tregun e energjisë elektrike ⁶²	±	Po		S.K.E. 2018-2030 ⁶³		Referencë e paplotë
3	Ngritja e bursës së energjisë	±	Po		S.K.E. 2018-2030 ⁶⁴		Referencë e paplotë
4	Biznesi do të furnizohet më lirë dhe më mirë, duke rritur konkurrueshmërinë e tij dhe mundësitë për të gjeneruar punësim	?	Po				Nuk ka reference dhe nuk mund të matet
5	Do të zhdukim nga qarkullimi gjeneratorët	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Përmenden synimet, e pamatshme
6	Kompanitë publike do të rikthejmë në ekonomiksht të qëndrueshme, me fokus kryesor mirëadministrimin e OSHE-së	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë
7	Investimet në rrjetin e shpërdarjes do të shkojnë atje ku duhet	√	Po		S.K.E. 2018-2030		

⁵⁹ Heqim traun e Rrugës së Kombit

⁶⁰ <https://dosja.al/programi-i-pd-se-per-energji-ne-basha-basha-shqiperia-ka-ngecur-ne-vendnumero-me-ramen-keto-8-vite/>

⁶¹ duke ngritur një sistem faturimi me dy fasha dhe duke ulur çmimin e energjisë për ata që konsumojnë deri në 300 kv/orë në muaj duke u dhënë konsumatorëve mundësi të zgjedhin vetë se te cili operator do ta blejnë energjinë

⁶² <https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/23.Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20e%20Energjis%C3%AB%20p%C3%ABr%20periudh%C3%ABn%202018%20-%20202030.pdf>

⁶⁴ <https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/23.Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20e%20Energjis%C3%AB%20p%C3%ABr%20periudh%C3%ABn%202018%20-%20202030.pdf>

8	Bashkimin e tregjeve të energjisë me Kosovën ⁶⁵	√	Po		S.K.E. 2018-2030		
9	Do të rritim sigurinë e furnizimit me energji në vend ⁶⁶	√	Po		S.K.E. 2018-2030		
10	Shqipëria do të kthehet në një qendër për furnizimin me energji të mbarë Ballkanit, po edhe me gaz natyror, i cili do të forcojë ekonominë tonë	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë
11	Do të lidhim gazsjellësin TAP me TEC-in e Vlorës, do të gazifikojmë zonat industriale dhe do të aplikojmë projektin e magjstralit Jon-Adriatik, duke siguruar një lidhje me magjstralin e gazit me Kosovën	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë
12	Rezervat hidrike të KESH sh.a. do t'i përdorim për energjinë e balancimit apo energjinë në pik	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë
13	Do të ulim çmimin dhe do të rrisim cilësinë e karburantit për qytetarët, përmes politikave fiskale	?	Po				Nuk ka referenca të matshme
14	Lufta pa kompromis ndaj korrupsionit, evazionit dhe kontrabandës që sot ka kapur sektorin energjetik	√	Po		S.N.K. 2015-2020 ⁶⁷		
15	Do të zhdukim monopolet dominuese në tregun hidrokarbur, si dhe do të forcojmë luftën ndaj evazionit fiskal	?	Po				Nuk ka referenca të matshme
16	Do të mundësojmë dyfishimin e investimeve private në sektorin e naftës	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë

⁶⁵ duke kombinuar prodhimin për energji elektrike të përdoret për të mbuluar kërkesën në kohën e pikut

⁶⁶ përmes investimeve në burime energjie të gjelbërta e të pastra me fokus energjinë hidrike dhe të erës

⁶⁷ <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/VKM-Nr.-516-01.07.2020.pdf>

17	Kontrolli i rreptë i cilësisë së karburanteve do të jetë një tjetër prioritet absolut	±	Po		S.K.E. 2018-2030		Referencë e paplotë
18	Cilësia e karburantit për përdorim industrial apo familjar do të arrijë standardin europian brenda 180 ditëve të para të qeverisjes	?	Po				Nuk ka referenca të matshme
19	Në sektorin mineral, ne angazhohemi për të rritur 150% Investimet e Huaja Direkte	±	Po	KMF 2022-2024	P.I.J-U 2016-2025	ERP 2021-2023	Nuk është e plotë

PREMTIME PËR INFRASTRUKTURËN DHE TRANSPORTIN

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Përfundimi me shpejtësi i riparimit dhe rehabilitimit të të gjitha dëmeve të tërmetit	±	Po	PBA 2021-2023			Nuk është e plotë
2	Furnizimi me ujë 24 orë	±	Po	PBA 2021-2023	S.K.S.F.U.K 2020-2030 ⁶⁸		Nuk është e plotë

PREMTIME FISKALE DHE BUXHETORE

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Ulja e sigurimeve shoqërore në 18%	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
2	Taksa e sheshtë 9 % për tatimin mbi të ardhurat personale duke ruajtur fashën mbrojtëse ekzistuese prej 30 mijë lekësh	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
3	Heqje e akcizës së naftës për karburantet për automjetet	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë

⁶⁸ https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_252_Strategjia%20UK%202020-2030.pdf

4	Taksa 9 % ndaj fitimit të sipërmarrjeve shqiptare me xhiro vjetore mbi 14 mln lekë të reja	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
5	Taksë e sheshtë 9 % duke tërhequr investimet e huaja	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
6	Totali i taksave dhe tarifave vendore nuk do të jetë më i lartë se 0.5 % e xhiros për biznesin e vogël dhe të mesëm	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Referencë e paplotë
7	Ngritja e një Bordi të Transparencës Fiskale që do monitorojë zbatimin e politikave fiskale nga bizneset	√	Po		S.S.M.F.P 2019-2023		
8	Rimbursim automatik i TVSH-së	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Përmenden synimet, e pamatshme
9	Anulimi i taksës prej 24 lekë të reja për litër mbi karburantin	?	Po				Nuk ka referenca
10	Heqja e TVSH për ushqimet bazë	?	Po				Nuk ka referenca
11	TVSH prej 6% mbi të gjitha kompanitë në sektorin e turizmit	√	Po	LIGJI 40/2018 ⁶⁹			
12	Arritja e menjëhershme e nivelit të financimeve të vendeve të rajonit për artin dhe kulturë	±	Po	PBA 2021-2023	S.S.M.F.P 2019-2023	ERP 2021-2023	Përmenden synimet, e pamatshme
13	Shpenzime të zbritshme sponsorizimet për artin, kulturën dhe sportin shqiptar ⁷⁰	±	Po	PBA 2021-2023			Referencë e paplotë

⁶⁹ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=3517>

⁷⁰ <http://ata.gov.al/2021/04/09/basha-prezanton-programin-e-pd-per-artin-kulturen-dhe-trashegimine-do-ndertojme-teatrin-sic-ishte/>

PREMTIME POLITIKE⁷¹

Nr	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program elektoral	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
